

Kumbona e së Diellës



KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT
Nr.9/10, Shtator - Tetor 2019

DËSHMORËT FLORI E LAURI NË DARDANI

Me 18 gusht 2019

Binjakë, në një epokë të paqartë, ikën nga Bizanti pas martirizimit të dy të krishterëve gurgdhendës, të cilët u kishin mësuar mjeshtërinë e tyre. Shkuan në Iliri (në qytetin Ulpiana, afër Prishtine) dhe punuan te qeveritari i vendit, i cili më pas i dërgoi të një princ. Ai u dha para dhe skica për të ngritur një tempull të gurtë idhujtarie. Ndërkaq paratë i dhanë si lëmoshë.

Në martiologjin romake, dali emrat dhe vendi i martirizimit të Florit dhe Laurit në Ulpianë si dhe mësuesit e tyre, Prokul dhe Maksim. të cilët janë nderuar si ne Kishën e lindjes apo ashtu edhe të perëndimit. Danile Farlati dëshmon se Prokuli dhe Maksimi janë martirizua në kohen e mbretit Hadrijan (117-138). Po në këtë kohë duhet të jenë martirizua edhe Flori dhe Lauri. Gjatë pushtetit të mbretit Konstantinit të Madh, (306-337), janë gjetur mbetjet e Shën Florit dhe Shën Laurit dhe janë transportua në Kostandinopojë afër Kishës së Shën Filipit.

Natën luteshin, ndërsa ditën punonin. I ndihmonte një engjëll, kështu godina mbaroi shpejt. Ndërkohë u tërhoq në besimin e vërtetë edhe prifti i perëndive të rreme, i biri i të cilit ishte tashmë i krishterë, pasi të dy vëllezërit i kishin hapur syrin e tij të verbuar.


Më pas shenjtoret mblodhën të varfrit që kishin përdëllyer dhe, pasi i lidhën me litar idhujt, i tërhoqën të gjithë poshtë. Në vazhdim inaguruan në mënyrë festive dhe me drita të shumta tempullin dhe ia dedikuan Shpëtimtarit Jesu Krisht, duke psalur, siç thuhet, troparin që duhej “Lavdi ty, o Krisht Perëndi, mburrja e apostujve...”

Princi, sapo e mori vesh, urdhëroi dhe të tjerët u dogjën në furrë, ndërsa Flori (latinisht do të thotë: i lulëzuar) dhe Lauri (latinisht do të thotë: i dafintë) u lidhën në rrota qerreje dhe u rrahën. Më pas u dërguan te qeveritari, i cili i mbylli në një pus të tharë, brenda të cilit mbaruan duke u lutur për besimtarët.

Pas shumë vjetësh lipsanet e shenjta u vendosën në këllëf, rridhnin miro dhe bënin mrekulli në mënyra të ndryshme në gjithë ata që vinin. Pra dëshmohej eshtrat e tyre qenë vendosur në Manastirin e famshëm të të Gjithëpushtetshmit (Pandokratorit) në Konstantinopojë afër Kishës së Shën Filipit.



* * *





Redaksia KONCILI I II-TË I VATIKANIT	4
Mons. George Frendo MARTESA DHE FAMILJA	6
Dom Lush GJERGJI SHËN NËNË TEREZA DHE VIRGJËRA MARI	10
Don Nosh Gjolaj NDIKIMI SOCIAL SI DHE TERAPIA GRUPALE	13
Giovani Cucci S.I.-Massimo Marelli S.I USHTRIMET SHPIRTËRORE TË SHËN INJACIT	16
Zija Vukaj HOMAZH PËR MIGJENIN	19
Mërgim Korça NJË JETË E SHKRIRË PËR FÉ E ATDHË	21
Fatmira Nikolli KISHA E BALLDRENIT E SHEK.XIII OSE KUR NJË PRIFT MUND NJË SHTET	25
Redaksia RIVENDOSËT PLLAKATË NË SHTËPINË E MIGJENI!	27
VITRINA E LIBRIT	28

KUMBONA E SË DIELLËS

Viti XXXII, nr. 9/10 (523-524) Shtator - Tetor 2019

Revistë
Fetaro-Kulturore
Drejtues
Imzot Angelo MASSAFRA

Redaksia
Dom Nikë Ukgjini (Kryeredaktor)
Dom Vlash Palaj
Dom Gjovalin Simoni

Adresa:
Arqipeshkvia Shkodër
Sheshi Gjon Pali II
Tel. 0222-42764
Fax. 0222-43673
e-mail: n_ukgjini@yahoo.it
Web page: kishakatolikeshkoder.com

Redaktor teknik: Xhon Nika

KRYEDIOQEZA METROPOLITANE SHKODËR - PULT

KONCILI I II-TË I VATIKANIT

Me Koncilin II Kishtar të Vatikanit, përruruar në Romë nga Papa Gjoni XXIII më 11 tetor të vitit 1962. Me të Kisha do të niste një rrugë ndryshimesh: do të zbriste në botë, duke thyer skemat shekullore; do të bashkohej me mbarë familjen njerëzore, duke jetuar së bashku me të frikën e shpresën, gëzimet e ankthet. Hapje kilometrike e revolucionare, fiksuar në mënyrë të pashlyeshme në faqet e njohura të Kushtetutës baritore "Gaudium et Spes".

R.Sh. - Vatikan

Duke shfletuar kalendarin historik, më 11 tetor, kujtojmë inaugurimin e punimeve të Koncilit II të Vatikanit, më 11 tetor 1962. Nga institucion te komuniteti i besimtarëve: ky është revolucioni që Kisha që vë në jetë me Koncilin II Kishtar të Vatikanit, përruruar në Romë nga Papa Gjoni XXIII më 11 tetor të vitit 1962. Me të Kisha do të niste një rrugë ndryshimesh: do të zbriste në botë, duke thyer skemat shekullore; do të bashkohej me mbarë familjen njerëzore, duke jetuar së bashku me të frikën e shpresën, gëzimet e ankthet. Hapje kilometrike e revolucionare, fiksuar në mënyrë të pashlyeshme në faqet e njohura të Kushtetutës baritore "Gaudium et Spes". Punimet e këtij Koncili kishtar u mbyllën nga Papa Pali VI më 8 dhjetor 1965, në të cilin morën pjesë nga 2549 prelatë a etër kishtarë prej pesë kontinenteve.

Pyetja kryesore, e ngulur fort në mendjen e Papës Gjoni XXIII, që në muajt e parë të papnisë së tij, ishte: "Ç'duhet bërë për Kishën e për botën, ku jetojmë sot?". 25 janar 1959. Papa Giuseppe Angelo Roncalli bëri pothuajse papritur e pa kujtuar, një vizitë në Bazilikën Ostiense, në Romë. Më pas, në manastirin e Shën Palit, u flet kardinajve. Kujton hollësisht tre muajt e parë të papnisë, foli për rreziket, që kërcënonin botën moderne e pastaj, me thjeshtësinë më të madhe, shtoi fjalët, që do të shënonin hapin e parë të risimit të Kishës: - "Për t'iu përgjigjur nevojave të popullit të krishterë, njoftojmë se së shpejti do të kremtojmë një koncil ekumenik universal... Mendojmë të tingëllojë edhe si ftesë drejtuar bashkësive të ndara, për kërkimin e unitetit. Kardinajtë e ndjekin pa frymë: është ngjarje, pak të themi, e



jashtëzakonshme, e jo më pak, e rrezikshme. T'i mbledhësh të gjithë ipeshkvijtë e botës e t'u thuash: "Të diskutojmë së bashku për Kishën e për botën!".

Po kjo do të thotë të shkaktosh një stuhi të fuqishme, madje, një tërmet. Po Papa Gjoni vë buzën në gaz, ashtu si dinte të bënte vetëm ai: "Do të jetë mes nesh edhe Shpirti Shenjt, tha. Prandaj unë nuk kam aspak frikë. T'i vihemi, pra, punës". Koncili II i Vatikanit nisi në orën 8.30 të datës 11 tetor 1962. 2500 ipeshkvij, nga të

katër anët e botës, vërshojnë në Shën Pjetër e nisin diskutimet. Diskutime krejt të hapura, madje nganjëherë edhe të ndezura. Argumentet tundin shpirtat: bëhej fjalë për marrëdhëniet e Kishës me botën politike, botën punëtore, botën kulturore; për Meshën Shenjte e jetën liturgjike të katolikëve, për luftën e paqen, urinë e etjen, begatinë e skamjen.

Nësa vijonin diskutimet e tyre të zjarrta, 2500 ipeshkvijtë i ngulnin mirë në kokë fjalët e thjeshta e njëherësh revolucionare, që Papa Gjoni XXIII ua përsëriti të gjithëve: "Ta duam njëri-tjetrin, të tjerat vijnë vetë". "Duhet ta mërijmë mëkatin, jo mëkatarin. Të flasim fjalë, që na bashkojnë, jo që na ndajnë. Ta kapërcejmë çdo pengesë, që shkakton përçarje".

Më 8 dhjetor mbyllej seanca e parë e Koncilit. Fjalët e Papës janë fllad i freskët besimi: "Diskutimet tuaja i treguan botës lirinë e shenjtë të bijve të Hyjit... Mirupafshim pas nëntë muajsh". Po kush ia nguli mirë sytë fytyrës së Papës këtë ditë, kishte një përshtypje të dhimbshme: Papa Gjoni ishte keq. Do ta shikonin përsëri pas nëntë muajsh? Të Enjten e Madhe të vitit 1963, Papa Gjoni i dhuroi botës enciklikën e madhe "Pacem in Terris".

Në Nju Jork, të përditshmet qenë të parat, që e botuan tekstin. Nën titujt me shkronja vigane, shkruhej:

“Papa kërkon të marrë fund riarmatosja!”. “Ndalojeni garën e armatimeve!”.

Times e Londrës e quan: “Mesazh drejtuar mbarë botës”. Presidenti Xhon Kenedi, nga Universiteti i Bostonit, tha për Pacem in Terris: “Si katolik, krenohem me të; si amerikan, mësoj shumë prej saj”.

Dokumentet e Koncilit të II Kishtar Ekumenik të Vatikanit përmbajnë një pasuri tejet të madhe për formimin e brezëve të reja të krishtera, për formimin e ndërgjegjes sonë. Dokumentet e Koncilit II të Vatikanit, tek të cilat duhet të rikthehemi, duke i çliruar nga masa e madhe e botimeve, të cilat shpesh, në vend që t'i bëjnë të njohura, i fshehën, janë edhe për kohën tonë busull, që i krijon barkës së Kishës kushtet për të dalë në det të hapur, mbi valët të stuhishme a të shtuara e të qeta, për të lundruar e sigurt e për të arritur tek caku.

Prandaj, duhen lexuar e studiuar, e po kështu edhe Katekizmin e Kishës Katolike, e në këtë mënyrë do rizbulojmë sa gjë e bukur është të jesh i krishterë, të jesh Kishë, të jetosh atë 'ne' të madhe, që Jezusi formoi rreth vetes, për të ungjillëzuar botën: 'ne' të Kishës, që nuk mbyllet kurrë, që është gjithnjë e hapur, për t'ua kumtuar Ungjillin të gjithëve. Koncili foli edhe mbi përgjegjësinë e laikëve, për çka pati ngulur këmbë Papa Pali VI, kur në Frascati më 1 shtator 1963, tha se ajo nuk vjen 'vetëm nga nevoja e zgjatjes së krahëve (duarve) të meshtarit, i cili nuk mbërrin tek të gjitha mjediset e nuk arrin t'i bëjë ballë të gjitha punëve të mundimshme. Ajo vjen nga një diçka shumë e thellë e më thelbësore, nga fakti që, edhe laiku është i krishterë”.

Të gjithë jemi përgjegjës, të gjithë jemi bashkëpërgjegjës. Zoti i thërret të gjithë njerëzit, duke i ndarë dhuratat për detyra të ndryshme në Kishë. Ai thërret në udhën e meshtarisë e të jetës së shuguruar, e thërret në martesë e në angazhim si laikë në të njëjtën Kishë si dhe në shoqëri. Koncili II i Vatikanit, pra, na thotë se detyra themelore e Kishës është t'i tregojë mrekullitë e Zotit njeriut të kohës sonë, t'i kumtojë atij Ungjillin e Krishtit. Mbi këtë bazohet dialogu, bashkëndarja, përgjegjësia e përbashkët: duhet të

nisemi nga këto rrënjë të thella, në të cilat ne besojmë se është e rëndësishme të kthehemi. Ne nisemi nga Koncili, i cili duhet të na ndihmojë në këtë kohë të re, ku duam të dëshmojmë sa bukur është të jesh i krishterë.

Ne shikojmë se koha, në të cilën jetojmë, vijon të jetë koha e harresës, kohë që e bën veshin të shurdhër për zërin e Zotit. Prandaj, duhet ta nxëmë mirë mësimin më të thjeshtë e më themelor të Koncilit, atë, që na kujton se krishterimi, në thelb, është besim në Zotin, në dashurinë trinitare dhe takim personal e komunitar me Krishtin, që i prin jetës sonë, e udhëheq atë: të tjerat janë rrjedhoja.

E në këtë datë të rëndësishme të 11 tetor, t'i kujtojmë katër pikat themelore të busullës së Koncilit II të Vatikanit, që mund ta orientojnë edhe Kishën e sotme në misionin e saj ungjillëzues: Kushtetutat Koncilare 'Sacrosantum Concilium', 'Lumen gentium', 'Dei Verbum' dhe 'Gaudium et spes', me urimin që trashëgimia e Koncilit t'i ndihmojë të krishterët ta rizbulojnë çdo ditë bukurinë e fesë. Gjëja më e rëndësishme sot, pikërisht ashtu siç dëshironin Etërit Konciliarë, është të shikohet, përsëri e qartë, se Zoti është i pranishëm, se na shikon, na përgjigjet. E edhe se, kur mungon besimi në Zotin, shembet gjithçka është themelore, sepse njeriu humbet dinjitetin e vet më të thellë, humbet atë që, në kundërshtim me çdo reduksionizëm, e bën të madh humanitetin e tij.



Mons. George FRENDO

MARTESA DHE FAMILJA NË DOKTRINËN E SHKRIMIT TË SHENJTË

Për fat të keq, duhet të pranojmë se ka shumë katolikë që nuk kujdesen fare për të kremtuar kurorën e martesës së tyre në Kishë. Të gjithë, duke bërë katekizëm për pagëzim ose për krezmim, kanë mësuar se sakramentet janë shtatë, ndër të cilat kurora e martesës. E megjithatë shumë mendojnë se martesa është thjesht një kontratë private, që mund të zgjidhet kur të duan; thjesht një kontratë para shtetit, e shoqëruar me një festë të madhe. Ndërsa para Kishës dhe para Zotit nuk janë të martuar, dhe as nuk mund të pranojnë sakramentet e rrëfimit dhe të kungimit. Janë në një situatë të çrregullt. Kur dhëndri dhe nusja, ose të paktën njëri prej tyre, është i pagëzuar në Kishën katolike, atëherë janë të detyruar të kremtojnë martesën në Kishë. Në kohën e komunizmit nuk ishte e mundur të martoheshin në Kishë, por tani të gjithë kemi mundësi të takohemi me Krishtin duke kremtuar sakramentet në Kishë, përfshirë edhe sakramentin e martesës.

Kurora e martesës është sakrament. Domethënë është një takim me Jezu Krishtin, i cili i bën pjesëtarë në dashurinë dhe shenjtërinë e tij nëpërmjet gjendjes martesore dhe familjare. Nëpërmjet Kishës, Ai pranon pëlqimin e bashkëshortëve që i japin vetveten njëri-tjetrit, dhe u jep hir që, duke dashur njëri-tjetrin sipas modelit të dashurisë mes Krishtit dhe Kishës, ndihmojnë njëri-tjetrin ta arrijnë shenjtërinë në jetën bashkëshortore dhe ata vetë bëhen dritë për shoqërinë dhe apostuj të ungjillit të Krishtit në botë.

Doktrina e Besëlidhjes së Vjetër

Fjala e Hyjit, domethënë Shkrimi i shenjtë, e vlerëson martesën sipas planit të Hyjit. Libri i Zanafillës, që është libri i parë i Biblës, fillon me tregimet e krijimit. Në këto tregime mund të shohim se martesa është pjesë e atij plani që Zoti e pa “shumë të mirë”. Domethënë, martesa është diçka e mirë. Madje profetët e kanë paraqitur si një shenjë të shenjtë, sepse e kanë vlerësuar si një shenjë shumë të përshtatshme për të përkufizuar lidhjen mes Hyjit dhe popullit të tij.

Fola për “tregimet e krijimit”, sepse në fakt kemi dy tregime. Dhe në të dyja tregimet kemi një teologji të jetës martesore. Në tregimin e parë (që gjendet në kapitullin e parë të librit të Zanafillës) lexojmë: “Hyji krijoi njeriun në përngjasimin e vet. E krijoi në përngjasimin e Hyjit: e krijoi mashkull e femër” (Zan 1, 27). Këtu flitet për dinjitetin e barabartë të burrit dhe të gruas, meqë përngjasimi i



Hyjit gjendet tek të dy. Pastaj lexojmë se Zoti, pasi e krijoi çiftin e parë, e bekoi duke u thënë: “Shtohuni e shumohuni e mbusheni tokën dhe sundojeni atë” (Zan 1, 28). Atëherë ngjizja e fëmijëve, bashkë me dashurinë reciproke, konsiderohet si qëllimi kryesor i bashkimit martesor.

Në tregimin e dytë (që është në kapitullin e dytë të Zanafillës, por në fakt është më i vjetër se tregimi që lexojmë në kapitullin e parë) flitet për krijimin e gruas: “Zoti e përftoi gruan prej brinjës që ia kishte nxjerrë njeriut” (Zan 2, 22). Shkrimtari i shenjtë tregon dinjitetin e gruas, që është i së njëjtës natyrë me atë të burrit: “Atëherë njeriu klithi: “Kjo tash është ashti i eshtrave të mi dhe mishi i mishit tim! Le të quhet grua, sepse kjo u mor nga njeriu”» (Zan 2, 23). Në versionin origjinal hebre shprehet më mirë kjo ide: “Le të quhet ishsha (grua), sepse kjo u mor nga ish (burrë)”. Pasi Hyji i krijoi u tha: “Për këtë arsye njeriu do ta lërë të atin dhe t’ëmën e vet dhe do të jetojë bashkë me gruan e vet dhe do të bëhen një trup i vetëm” (Zan 2, 24). Në këtë mënyrë pra, shkrimtari i shenjtë na paraqet bashkimin martesor si një bashkim të pakrahasueshëm me asnjë bashkim tjetër.

Bashkimi i burrit dhe i gruas në martesë është aq i fortë, sa që për shkak të saj burri “do ta lërë të atin dhe t’ëmën e vet” dhe të dy “bëhen një trup i vetëm”. Kjo shprehje do të thotë se bashkimi i tyre në dashuri kërkon që të bashkëndajnë gjithçka mes tyre, është një bashkim në zemër dhe në trup. Në këtë mënyrë bashkimi martesor dallohet nga çdo lloj bashkimi tjetër, dhe dashuria martesore dallohet nga çdo lloj dashurie tjetër.

Në këto dy tregime duket qartë se martesa, sipas planit origjinal të Zotit, është një bashkim



total mes dy personave të barabartë dhe të sekseve të ndryshme (atëherë dënohet martesë mes dy homoseksualëve). Është një bashkësi monogamike, mes *një* burri dhe *një* gruaje (atëherë nuk lejohet poligamia). Është një bashkësi e pandashme (pra nuk lejohet divorci). Kjo bashkësi kërkon besnikëri (pra dënohet kurorë thyerja). Dhe është bashkim i dy personave të barabartë në dinjitet.

Kapitulli i tretë flet për mëkatën e parë të çiftit, mëkati që ka pasur pasoja të rënda edhe për martesën. Martesa, sipas planit original të Zotit, ishte monogamike dhe e pazgjidhshme. Por pas mëkatit, u pranua poligamia dhe divorci. Gjithashtu, në planin original të Zotit, martesë duhej të ishte bashkim i dy personave, burrë dhe grua, të barabartë në dinjitet. Por pas mëkatit shohim nënshtrimin e gruas ndaj burrit.

Megjithatë në shkrimet më të vonshme të Besëlidhjes së Vjetër flitet me shumë forcë kundër kurorë thyerjes dhe kundër divorcit. Në librin e Fjalëve të Urta lexojmë: “Kush shkel kurorën është i pamend, kushdo që ta bëjë këtë, e humb jetën e vet” (6, 32-33). Dhe profeti Malaki thotë: “Zoti është dëshmitar ndërmjet teje e gruas së rinisë sate, së cilës ti iu bërë i pabesë. E pra, kjo është bashkëshortja jote dhe gruaja e besëlidhjes sate! Pse a nuk e bëri një qenie të vetme që ka mish e frymë të jetës? Ruajeni, pra, shpirtin tuaj e gruas

së rinisë sate ruaj se i bëhesh i pabesë, sepse unë e urrej divorcin, thotë Zoti” (2, 14-16).

Besëlidhja e Vjetër na paraqet disa çifte si model. Ndër të cilat mund të dallojmë Jakobin dhe gruan e vet Rakelën; gjithashtu Tobinë dhe gruan e vet Sarën. Për t'u martuar me Rakelën, Jakobi i shërbeu babait të saj Labanit për shtatë vjet, që Jakobit “iu duk si të ishin pak ditë prej dashurisë së madhe ndaj saj” (Zan 29, 20). Dhe pasi që Labani e mashtroi Jakobin duke i dhënë vajzën tjetër Linë në vend të Rakelës, Jakobi pati kurajë t'i shërbejë Labanit edhe shtatë vjet të tjera (29, 30). Ndërsa për Tobinë thuhet se para se të takohej me Sarën “e desh i aq fort sa që s'mundte ta largonte zemrën e vet prej saj” (Tob 6, 18).

Në librin e Samuelit lexojmë: « *Ana nisi të qajë e s'deshi të hante. Atëherë Elkana, burri i saj, i tha: “Anë, pse po qan e nuk ha? Pse po vuan në zemrën tënde? A nuk jam unë më i mirë për ty se t'i kishe dhjetë djem?”* » (1 Sam 1, 8). Pra edhe në Besëlidhjen e Vjetër flitet me këmbngulje për dashurinë bashkëshortore si qëllim të jetës martesore.

Në profetët shohim një zhvillim shumë domethënës: ata kanë folur për bashkim dashurie mes Hyjit dhe popullit duke përdorur shembullin e dashurisë martesore. Sikurse burri dhe gruaja duan njëri-tjetrin dhe dashuria i ka bashkuar në martesë, ashtu edhe Hyji ka dashur popullin e vet, dhe kjo

dashuri u shpreh në besëlidhjen që Zoti bëri me popullin e Izraelit.

Kënga e Këngëve është tërësisht një poezi e bukur që shpreh dashuri mes dy të fejuarve. Në fund të poezisë lexojmë: “M’vendos si vulë mbi zemrën tënde, porsì vulë mbi dorën tënde, se dashuria është e fortë si vdekja, i pashmangshëm është si dheu i zi lakmimi; vapa e saj si vapa e zjarrit, flakë hyjnore! Ujërat e mëdha dashurinë nuk mund ta ndalin, nuk e fikin as lumenjtë! Kush do të jepte gjithçka ka në shtëpinë e vet me qëllim që të blejë dashurinë, do të përbezej prej gjithkujt.”

Doktrina e Besëlidhjes së Re

Me ardhjen e Jezu Krishtit, gjendja e martesës u ndryshua shumë në të mirë. Ai, Shpëtimtari ynë dhe Shpëtimtari i jetës martesore, theksoi njësinë totale mes burrit dhe gruas në mënyrë që, çka Hyji bashkoi njeriu të mos e ndajë. Kur një ditë e kanë pyetur Jezusin: “A ka leje burri ta lëshojë gruan?” Jezusi u përgjigj: “Çka ju urdhëroi Moisiu?” Ata i përgjigjen: “Moisiu lejoi *të shkruhet letra e divorcit e të lëshohet*.” Jezusi u tha: “Atë rregullore Moisiu e shkroi për ju për arsye të kryeneçësisë suaj. Por në fillim të botës, Hyji *’i krijoi mashkull e femër. Prandaj njeriu do ta lërë babain e vet e nënën e vet e do të bashkohet me gruan e vet, e kështu të dy do të jenë një trup i vetëm*.” Këndeja pra, nuk janë më dy, - por një trup i vetëm. Prandaj, çka bashkoi Hyji, njeriu të mos guxojë ta ndajë!” Në shtëpi nxënësit e pyetën përsëri për të njëjtën gjë. Ai u tha: “Kush e lëshon gruan e vet e merr një tjetër, bën kurorë thyerje kundër së parës. Po qe se edhe gruaja e lëshon burrin e vet e martohet me një tjetër, bën kurorë thyerje.”

Në Besëlidhjen e Vjetër burri kishte të drejtë të ndahej nga gruaja, por gruaja për asnjë arsye nuk kishte të drejtë të ndahej nga burri. Por me të drejtë Shën Jeronimi thotë: “Çka në Besëlidhjen e Vjetër nuk i lejohej gruas, tani nuk i lejohet as burrit”. Shën Jeronimi pra, duke folur për pazgjidhshmërinë e jetës martesore, thotë se me përgjigjen e tij Jezusi ka nxjerrë në pah dinjitetin e barabartë të burrit dhe të gruas. Jezusi ia ktheu gruas dinjitetin e saj origjinal. Siç thotë Shën Pali: “Nuk ka më mashkull ose femër: të gjithë ju jeni një në Krishtin Jezus” (Gal 3, 28).

Besëlidhja e Vjetër, e cila, në fakt, është historia e jetës familjare, tregon dinjitetin e familjes. Në Besëlidhjen e Re, në mënyrë të veçantë ky dinjitet i jetës familjare shfaqet kur Fjala e Hyjit, Biri i Atit, hyri në historinë e njeriut, dhe hyri në historinë e njeriut nëpërmjet familjes. Ishte e mundshme për Birin e Hyjit të bëhej njeri duke mos

lindur prej një gruaje dhe duke mos u rritur në një familje. Por Jezu Krishtit i pëlqeu kështu: të lindte prej një gruaje dhe të rritej në një familje.

Biri i Hyjit është bërë njeri dhe ka lindur, jetuar dhe është rritur brenda një familjeje. Qoftë Ungjilli i Mateut qoftë ai i Lukës, flasin për historinë e kësaj familjeje, të cilën ne e quajmë “Familja e shenjtë e Nazaretit”. Kështu Biri i Hyjit na u tregua ne, përmes familjes në të cilën ai ishte qendra. Dhe Jezusi na ka zbuluar dinjitetin e jetës familjare, por edhe angazhimin e duhur që fëmijët të rriten brenda rrethanash të përshtatshme feje dhe dashurie.

Gjatë gjithë jetës së Vet, Jezusi u interesua për jetën familjare: i afroi në mënyrë të veçantë familjet që vuanin, i deshi shumë fëmijët, pati mëshirë për vejushën e Naimit, etj. Jezusi duke treguar interes për jetën familjare na ka zbuluar edhe dinjitetin e jetës familjare si të tillë.

Dy Ungjilltarët Mateu dhe Luka na japin imazhe shumë realiste të jetës në familje, me momentet e saja të gëzimit dhe të trishtimit. Mund të imagjinojmë gëzimin e nënës, e cila lind një jetë të re; gëzimin e Marisë dhe të Jozefit, të cilët dëgjojnë këngën e engjëjve atë natë të lindjes së Jezusit; gëzimin e Marisë dhe të Jozefit kur pranojnë barinjët e varfër të Betlehemit si edhe magjistarët e pasur që erdhën nga larg për ta shikuar foshnjën e sapolindur; gëzimin e Marisë dhe të Jozefit kur dëgjojnë dëshminë e Simonit dhe të Anës që me fjalë shumë të bukura kanë lavdëruar atë foshnjë dyzetë ditëshe në Tempullin e Jerusalemit.

Por e njëjta familje e Nazaretit ka përjetuar edhe momente të vështira, kur Maria dhe Jozefi nuk gjetën asnjë vend ku Maria, në orët e fundit të shtatzanisë së saj, do të lindte fëmijën, kur ishin të detyruar të shkonin në mërgim në Egjipt për ta shpëtuar jetën e foshnjës Jezus, që ishte kërkuar për tu vrrarë nga Herodi. Këto momente ishin një provë e vështirë për fenë e tyre.

Këto janë edhe provat, në të cilat janë duke kaluar edhe shumë familje sot. Por në Shkrimin e Shenjtë lexojmë shpesh fjalët: “Mos ki frikë!” – “Mos kini frikë!” Janë fjalë që kanë dalë edhe nga goja e engjëjve për barinjët në Betlehem. Dhe janë fjalë, të cilat i dëgjojmë edhe sot, kur falë zhvillimit jemi bërë të zotët e vetes, por menjëherë vëmë re se jemi më të brishtë se kurrë. Familja sot më shumë se kurrë ka nevojë për engjëj që mund ta përcjellin porosinë: “Mos ki frikë, sepse Hyji është Emanuel – Hyji me ne!”

Me praninë e tij në dasmën e Kanës, kur ai bëri mrekullinë e tij të parë, Jezusi ka treguar se edhe

martesa i përket Mbretërisë së qiellit. Prania e Jezusit dhe e nënës së vet në atë dasmë ka vazhduar ta shenjtërojë jetën martesore, në mënyrë që tani nuk është vetëm një bashkim për të mirën e shoqërisë, por edhe një situatë e re në popullin e ri të Hyjit.

Dashuria martesore është një dashuri e veçantë, që atëherë shprehet edhe në mënyrë të veçantë. Sepse në martesë bashkëshortët i japin krejtësisht vetveten njëri-tjetrit. Kështu marrëdhëniet seksuale mes burrit dhe gruas janë shprehje e bashkimit të tyre në dashuri. Për këtë arsye Shën Pali thotë: “Gruaja nuk është pronarja e trupit të vet, por burri. Gjithashtu as burri nuk është pronari i trupit të vet, por gruaja. Mos ia mohoni njëri-tjetrit detyrën martesore, përveçse me marrëveshje e përkohësisht që t'i kushtoheni uratës, e bashkohuni përsëri që djalli të mos ketë rast t'ju tundojë për shkak të papërmbajtjes suaj” (2 Kor 7, 4-5).

Shën Pali ka përsëritur të njëjtën doktrinë të Jezusit për sa i përket pazgjidhshmërisë së martesës. Thotë ai: “Të martuarve u urdhëroj, jo unë, por Zotëria, që gruaja të mos ndahet prej burrit - por, po ndodhi që të ndahet, të mos martohet më ose të pajtohet me burrin - e burri të mos e lërë gruan.” Por pastaj flet për një rast të veçantë: “Në qoftë se ndonjë vëlla e ka gruan të pafë dhe ajo pranon të jetojë me të, të mos e lërë. Po ashtu edhe gruaja që e ka burrin të pafë dhe ai pranon të jetojë me të, të mos e lërë burrin. Sepse burri i pafë shenjtërohet prej gruas dhe gruaja e pafë shenjtërohet prej burrit të krishterë. ... Po qe se pala jo e krishterë do të ndahet, le të ndahet; i krishteri dhe e krishtera në raste të tilla nuk janë të lidhur: sepse Hyji na thirri në paqe.” Kisha ka kuptuar mirë këto fjalë: flitet për ashtu-quajturin “Privilegjin Pavlin”. Pra, sipas mësimit të Shën Palit dhe praktikës së Kishës, në qoftë se dy persona jo të krishterë martohen, njëri prej tyre pagëzohet ndërsa pala tjetër nuk pranon të banojë me palën e pagëzuar, ose e pengon në praktikën e besimit të krishterë, atëherë këta bashkëshortë nuk janë më të lidhur, dhe pala e pagëzuar mund të martohet me një person tjetër.

Por kulmi i doktrinës së Shën Palit rreth martesës gjendet në Letrën e tij drejtuar Efesianëve. Në kapitullin e pestë të kësaj letre Shën Pali shkruan: “Ju, o burra, duajini gratë tuaja sikurse Krishti e ka dashur Kishën dhe e ka flijuar vetveten për të për ta bërë të shenjtë duke e pastruar me larje dhe me fjalë, që të bënte gati për vete një Kishë të lavdishme, të panjollë, të parrudhë, pa ndonjë gjë si këto, të jetë e shenjtë dhe e pa të metë.

Në këtë mënyrë duhet që edhe burrat t'i duan gratë e veta - porsi trupin e vet. Kush e do gruan e vet, do vetveten.

Sepse askurrë askush nuk e urren trupin e vet, por e ushqen dhe kujdeset për të, porsi Krishti për Kishën. Sepse jemi gjymtyrët e Trupit të tij. *'Për këtë arsye njeriu do ta lërë babain dhe nënën e do të jetojë bashkë me gruan e vet e të dy do të jenë një trup i vetëm.'* Ky është mister i madh: e kam fjalën në lidhjen e Krishtit me Kishën. Shkurt, për sa u përket juve, secili prej jush le ta dojë gruan e vet porsi vetveten e gruaja le ta nderojë burrin e vet.”

Profetët kishin bërë atë krahasim: sikurse burri dhe gruaja bashkohen në dashuri me njëri-tjetrin në martesë, ashtu edhe Zoti është bashkuar në dashuri me popullin e vet, që ata e quanin “nusja e Zotit”. Por tani Shën Pali e tejkalon këtë krahasim, sepse, me fjalë të tjera, u thotë bashkëshortëve: “Bashkimi juaj në martesë i përngjan bashkimit të Jezu Krishtit me Kishën”. Madje, ai u thotë gjithashtu: “Keni një model: shikoni Krishtin, sa dhe si e ka dashur Kishën e vet! Ashtu edhe ju duhet të doni njëri-tjetrin”. Dhe flet për bashkimin martesor si një bashkim në një trup të vetëm. Prandaj kush nuk respekton burrin ose gruan e vet, është kinse po urren trupin e vet. Dhe i kujton bashkëshortët fjalët e librit të Zanafillës: *'Për këtë arsye njeriu do ta lërë babain dhe nënën e do të jetojë bashkë me gruan e vet e të dy do të jenë një trup i vetëm.'*

Në Besëlidhjen e Vjetër, modeli për bashkëshortët ishte besëlidhja e Hyjit me Izraelin, ndërsa tani, në Besëlidhjen e Re, modeli i ri është misteri i bashkimit të Krishtit me Kishën.



Dom Lush GJERGJI

SHËN NËNË TEREZA DHE VIRGJËRA MARI

*“Unë jam shërbëtorja e Zotit. Më ndodhtë siç the ti!” (Lk 1, 38)**“Kur Maria qe lajmëruar prej engjëllit Gabriel, ajo ishte kufizuar vetëm në një pyetje: nuk arrinte ta kuptonte si do ta tërhiqte dhurimin e vetvetes që ia kishte bërë Zotit. Engjëlli, ia shpjegoi dhe ajo fill e kuptoi. Në atë çast, buzët e saja shqiptojnë një përgjigje të mrekullueshme, që e definonte atë në tërësinë e qenies grua: “Më ndodhtë siç the ti!” (Nëna Tereze)*

Në jetën e çdo njeriu ka çaste, situata, takime, persona të rëndësishme, vendimtare, që ne i bartim brenda. Ndonjë herë jemi të lumtur dhe themi: Çfarë fati, rasti, hiri i Zotit! Herët tjera pyetemi: pse është dashur të ndodhin kjo, kështu mua? Çfarë fatkeqësie!

Edhe në jetën e Virgjërës Mari pati takime, ngjarje dhe vendime të paharrueshme. Një takim i tillë ishte me engjëllin Gabriel, nëpërmjet tij, me vetë Zotin: vendimi për ta pranuar ofertën e qiellit, për të hapur dhe dhuruar zemrën virgjërore për ngjizjen dhe lindjen e Jezusit, Shëlbuesit dhe Vëllait të njerëzimit. Pas disa pyetjeve dhe paqartësive fillestare, erdhi përgjigja: *“Unë jam shërbëtorja e Zotit. Më ndodhtë siç më the ti!”* (Lk 1, 38).

Maria e pranon ofertën e Zotit, jo pse e kishte kuptuar më mirë misterin e mishërimit, por përse gjendej para dashurisë së Zotit, të cilit i përgjigjet me fe dhe çiltëri të plotë. Dhe Zoti nuk ishte ndalur me kaq, por herë pas here, kërkonte gjithnjë e më shumë, gjithçka, duke dhënë gjithçka – Birin e tij Jezu Krishtin.

Nëna Tereze thotë: *“Dëgjesa në të njëjtën mënyrë siç kishte dëgjuar Virgjëra Mari: “Më ndodhtë siç the ti!”. Vullneti i kujt? I engjëllit, i cili e zëvendësonte Zotin.*

Ajo, Mbretëresha e qiellit, e dëgjoi engjëllin, në të njëjtën mënyrë siç e dëgjonte Shën Jozefin, që për të e zëvendësonte Zotin... Askush nuk e ka mësuar kaq bukur mësimin e përvujtërisë si Maria. Ajo ishte shërbëtoare. Të jesh shërbëtoare domethënë të jesh në shërbim të dikujt, të punosh sipas vullnetit të dikujt, me besim dhe gëzim të plotë. Gëzimi dhe hareja ishin fuqia e Zojës Mari... Një dorëzim i plotë: të jesh në shërbim të Zotit që të përdorësh ashtu siç i pëlqen Atij... Përse e bëri këtë? Sepse Virgjëra Mari ishte plot me Zotin, sepse jetonte vetëm për Zotin, megjithatë konsiderohej vetëm si shërbëtoare e Zotit. Të bëjmë edhe ne kështu”.

Vështirësia e Marisë nuk kishte përfunduar. Madje, ato rriteshin dhe shtoheshin gjithnjë. Ajo mund të mendonte dhe të përfundonte kështu: mirë,

pranova me dashuri dhe për dashuri ftesën e Zotit, mirëpo çka duhet të bëjë tash me Jozefin? A do ta pranojë ai, të tjerët, këtë risi absolute, ngjizjen e Jezu Krishtit për virtut të Shpirtit Shenjt? Edhe Jozefi do të duhej të prante “të pamundshmen”. *“Jozef, biri i Davidit, mos ki frikë ta marrësh Marinë, të fejuarën tënde, sepse foshnja që është zënë në të, u zu për virtut të Shpirtit Shenjt. Ajo do të lindë djalë e ti ngjitja emrin Jezus, sepse Ai do ta shëlbtojë popullin e vet prej mëkateve të tija.”* (Mt 1, 20-21)

Zoti e sprovon edhe më shumë Marinë. Erdhi koha e lindjes së Jezusit. Gjendja është tejet e vështirë. Maria dhe Jozefi janë në udhëtim, në Betlehem. *“Tashti, ndërsa ata po gjendeshin atje, i erdhi koha të lindë. Ajo lindi djalë e vet – të paralindurin, e mbështolli në shpërgënj dhe e vendosi në grazhd, sepse në bujtinë nuk pati vend për ata”.* (Lk 2, 6-7)

Virgjëra Mari me çdo rast ka mund të mendonte kështu: Hyji im, çka dëshiron ende prej meje? E pabesueshme, e papranueshme! Shëlbuesi duhet të lindë në këto kushte?

Mirëpo, Zoti nuk “dorëzohet”, por kërkon gjithnjë më shumë dhe Maria e kujton edhe një herë premtimin e saj: Jam shërbëtoare e Zotit.

Historia mes Marisë dhe Zotit vazhdon. Fëmija tashmë ka lindur, gëzimi dhe lumturia ishte e madhe. Shpejt harrohen vuajtjet: gëzohet qielli, engjëjt, edhe toka, barinjët (khs. Lk 2, 8-20). Mirëpo, gëzimi dhe ngushëllimi zgjatë pak. Ja vështirësia tjetër, sprova e tmerrshme: Herodi dëshiron ta vrasë Jezusin Fëmijë! (khs. Mt 2, 7-18)

Vështirësia ishte e pamasë, rreziku tejet i madh, frika e tmerrshme, shtegdalja e paqartë. Çka të bëjnë? Jozefi dhe Maria kanë mund të mendojnë kështu: O Zot, ku je tash? Përse hesht, nuk flet, nuk thua asgjë, nuk bën diçka për ta shpëtuar Foshnjën, Birin tënd dhe tonë? Na shpëto ne dhe Jezusin nga kjo gjendje!

Asgjë! Zoti nuk bën asnjë mrekulli, nuk dëshiron të ndërhyjë drejtpërdrejt, por, rishtas e dërgon engjëllin me këtë porosi: *“Engjëlli i Zotit iu*



dëftua në ëndërr Jozefit e i tha: Çohu, merre fëmijën dhe t'ëmën e tij e ik në Egjipt. Rri atje deri që të them unë, sepse Herodi do ta kërkojë fëmijën për ta vrrarë.” (Mt 2, 13)

Zgjidhja është fatkeqësisht në ikje dhe në vuajtje!

Projekti i Zotit dëftohet gjithnjë më i vështirë, mirëpo edhe një herë ngadhënjëu dashura, Po-ja e Marisë, besnikëria, ndërsa “loja” e Zotit vazhdon...

“Maria në misterin e Lajmërimit dhe të pasisë paraqet modelin e vërtetë të jetës, sepse ajo e ka pranuar Jezusin në jetën e saj, pastaj ka shkuar me shpejti për ta lajmëruar kushërirën Elizabetën. Atë çka ajo kishte pranuar, deshi t’ia dhuronte asaj...” (Nëna Tereze).

I tillë është Zoti ynë. E tillë është Virgjëra Mari!

Edhe pse dita-ditës lindin pyetje dhe vështirësi të reja, përgjigja ishte vetëm një: Zoti do kështu, u bëftë vullneti i tij! Maria vazhdimisht gjendet në situata të panjohura, të rrezikshme, të paparaparë. Di vetëm një gjë, dhe kjo i mjaftonte, kështu do Zoti, dhe ajo lëshohet plotësisht në dorën e tij, me Po-në jetësore.

“Pasi që Zoti e do botën, ai e dërgoi Birin e vet. Tani ai të dërgon ty për të qenë Fjala e tij, dhe kjo fjalë duhet të mishërohet në zemrat e njerëzve. Ja pse kemi nevojë për Virgjërën Mari..., që të jemi të aftë që t’ua dhurojmë të tjerëve këtë dashuri.” (Nëna Tereze)

“Ati i mëshirshëm ka dashur që pranimi nga ana e nënës së përcaktuar t’i paraprinte mishërimit, në mënyrë që, sikurse një grua kishte ndihmuar në

dhënien e vdekjes, një grua të ndihmon në dhënien e jetës. Kjo vlen në mënyrë të jashtëzakonshme për Nënë e Jezusit, e cila i ka dhënë botës jetën që gjithçka përtërin dhe që prej Hyjit është pasuruar me dhurata që i kanë hije një nderimi të tillë... Kështu, Maria, bija e Adamit, duke e pranuar fjalën hyjnore, u bë Nëna e Jezusit, dhe duke e përqafuar vullnesën hyjnore të shpëtimit me gjithë shpirt, pa e penguar asnjë mëkat, ia kushtoi tërësisht vetveten si shërbëtore e Zotit, personit dhe veprës së Birit të vet, duke i shërbyer misterit të shpërblimit në varësi të tij dhe me të, me hirin e Hyjit të gjithëpushtetshëm.” (LG, 56)

Edhe ne, nëpërmjet pagëzimit, kemi dhënë Po-në Zotit, Jo- në e së keqes, mëkatit dhe vdekjes, kuptohet nëpërmjet prindërve dhe nunave tanë. Shpesh e kemi përsëritur këtë premtim edhe personalisht në sakramentin e rrëfimi dhe pajtimit, në Eukaristi, në marrjen e sakramentit të përforsimit. Po-ja jonë gjithnjë përtërihet, thellohet, siç bëri Maria, apo...? A jemi për po, vetëm me anë të fjalës, apo edhe me tërë jetën tonë, edhe në çaste kur kërkohet flijimi, vuajtja, pranimi i vullnetit të Hyjit me dashuri?

Jeta dhe shembulli i Marisë na mësojnë: Zoti kërkon shumë, ndoshta ne na duket edhe tepër, gjithçka, do “shkatërrimin” tonë, për ta realizuar Ai në ne dhe me ne veprën e vet, shëlbimin. Ai shpesh na sprovon, për ta treguar dashurinë dhe kujdesin e tij për ne, nëpërmjet jetës tonë dhe mangësive apo dobësive tona. Të jesh në disponim të Zotit domethënë të besosh, të duash, të pranosh dhe zbatosh me dashuri vullnetin e tij, të bësh një hap “në të panjohur”, në terr, por me siguri të plotë: Zoti do kështu, Ai vepron, dhe ne jemi të lumtur dhe të falënderueshëm për dashurinë, faljen dhe mëshirën e tij.

Maria, është kryevepra e dëgjësës, dhurimit, edhe më shumë, e fesë dhe dashurisë.

“Pa Marinë, s’ka Jezus. Para shumë vjet erdhi një engjëll për ta sjell lajmin e gëzueshëm te Maria. Princi i Paqes kishte dëshirë të flakët për të ardhur mbi tokë, dhe një engjëll ishte detyruar që ta binte këtë lajm të mirë që Krijuesi dëshironte të bëhej Fëmijë. Princi i Paqes që tërhequr nga një virgjër e re, e cila para syve të njerëzve nuk ishte asgjë. As engjëlli nuk e kuptonte pse ishte i dërguar te një krijesë e tillë. Po ajo ishte aq e bukur që Mbreti i mbretërve deshi të bëhej trup në të. Ishte me aq shumë hir, plot me Zotin.... Do të ketë mbetur e hutuar, sepse kurrë nuk kishte parë ndonjë engjëll... Pyeti: “Si? Çka thua? Nuk kuptoj. S’ka kuptim për mua!”. Engjëlli i tha thjeshtë: me fuqinë e Shpirtit Shenjt, Krishti do të mishërohej në të. Dhe

Maria u përgjigj vetëm me një fjalë: “Unë jam shërbëtoria e Zotit!” (Nëna Tereze)

Po-ja e Marisë, nuk ishte vetëm një çast, një fjalë, shprehje, por jetë e kushtuar Zotit, për Zotin, për mbarë njerëzimin. Edhe për ne vlen kjo strategji dhe metodologji: po-ja jonë do të duhej çdo ditë të përforcohej, vërtetohej, pasurohej dhe thellohej.

Dialogu i dashurisë, mes Qiellit dhe tokës, që në njëfarë mënyre ishte ndërprerë, me po-në e Marisë rishtas hapet, shkon kah përplotësimi dhe zbatimi, sepse ajo “ia hapi” rrugën dhe zemrën mishërimit të Jezu Krishtit,

Nëna Tereze, me dorë të saj, ka shkruar këtë uratë kushtuar Virgjërës Mari:

“Mari, Nëna e Krishtit,
na dhuro zemrën kaq të bukur,
kaq të pastër; kaq të pafajshme!
zemra jote me aq dashuri e mbushur dhe përvujtëri,
që edhe ne të mund ta pranojmë Jezusin
në Bukën e Jetës,
Ta duam si e ke dashur Ti,
T’i shërbejmë si i ke shërbye Ti,
të fshehur në më të varfrit! Amen.”

Maria, me po-në e madhe, është bashkangjitur me Shëlbuesin: Nëna – Biri, kështu që është bërë e para e “shpërblyer.” Ky mision dhe kjo detyrë, është në vazhdimësi në jetën e Virgjërës Mari, për Kishën, për çdo të krishterë, për çdo njeri.

Këtu gjejmë lidhjen e fortë Krishti – Maria – Kisha. Jezusi, është mishëruar në kraharorin e Virgjërës Mari, për virtyt të Shpirtit Shenjt, që të vazhdojë të lindë, të rritet edhe nëpërmjet Kishës. Maria dhe Kisha janë “vegla” të Shpirtit Shenjt, për çdo kohë dhe për shëlbimin e mbarë njerëzimit.

Shën Luani i Madh, shkruante kështu: “Gjithë atë çka Biri i Zotit ka mësuar dhe bërë për shëlbimin e botës, nuk e dimë vetëm prej historisë së kaluar, por e njohim edhe nga fuqia e ngjarjeve aktuale të Kishës dhe në Kishë”.

(Pjesë nga Libri: Don Lush GJERGJI, Jeta, Dashuria, Dëshmia, Përshpirtëria e Nënës Tereze, DRITA, 2016, f. 111-116)



Don Nosh GJOLAJ
Podgoricë

NDIKIMI SOCIAL SI DHE TERAPIA GRUPALE

(Pjesa e parë)

Shtëpia pranë shtëpive. Banesa pranë banesave. Aq shumë janë mbishkrime, emrat e shumë njerëzve. Aq shumë njerëz janë, që askush nuk i njeh. Shihen. Bashkë në lift. Pa ndonjë buzëqeshje në sytë e tyre.

Dihet se aty është dikush. Siç dihet se është aty cunga, në të cilën nuk bënë ta shkelsh, sepse do të rrëzohesh.

Siç pohon Phil Bosmans(1985):” Njerëzit e qytetit. Njerëzit vetëm në qytet. Qyteti, nuk është më një kënaqësi shoqërore të banimit”.

Me këtë temën dëshirojmë që t'i kthejmë vëmendjen në ftohtësi, që i mbështjellë dhe i mbulon vetëdijen e njeriut, ashtu edhe të çiftin martesor, të cilët aq shumë ngurohen dhe ftohën në bunkerët e vet të egoizmit të mbyllur. Çifti që jeton në vetmin dhe në shkretin e shterur, pa dashuri, ata duken si thneglat nëpër çerdhet e tyre, në rrugë, në tren, në tramvaj, në autobus, në vetura, në banesë, njerëz pa fytyrë dhe pa zemër.

Bota e sotme është e tillë, që i bënë njerëzit të varur njëri prej tjetrit, si në veshmbathje ashtu edhe në ushqim, në banesë dhe në pushime. Edhe më tepër janë të varur njëri prej tjetrit çka i përket fatit dhe fatëlumturis. Këtu nuk mund asgjë të behet me "para". Fati i çiftit dhe jo vetëm i tij por edhe i njerëzimit e ka lidhjen e vet, vetëm te "zemra" dhe te "dashuria", edhe kjo është gjithëherë falas.

Mbyllja e çiftit martesor në vetvete, për një kohët të gjatë është diçka e pamundur dhe jo reale.

Sepse ajo mbyllje paraqet në bërthamën e vet, një kërkesë që është e njëanshëm, për një farë fuqie, ose prestigjit, e cila shumë lehtë mund të çoroditet në sëmundjet psikiko-patologjike (psiko-shpirtërore), në një farë kanibalizmit. Në qoftë se ashtu e ndiejmë veten atëherë i themi shokut të martesës: "dëshirojë me qenë krejtësisht i yti ose e jotja", dhe atëherë e nënçmojmë mundësit tona reale. Nuk ka qenie njerëzore që mund me qenë ashtu i përsosur, dhe si i tillë i përkrye. Nuk ka mundësi që dikush të të zhvillohet gjatë natës aftësitë, cilat nuk i kishte përpara, ose ato aftësi që nuk i kishte të zhvilluara. Nuk mundemi papritmas dhe për krye natës të bëhemi partneri i lojës së shahit, në qoftë se në këtë lojë nuk jemi stërvitur përpara, gjatë asaj kohës, kur partneri ynë ka ushtruar dhe ka arrit suksese të mëdha, që është

bërë, fjala vjen, mjeshtër i shahit.

Shumica e njerëzve dhe e çiftëve të martesës nuk mund ta kuptojnë njeri tjetrin me ato fuqitë e veta dhe as nuk i kuptojnë faktet e tilla. Ashtu kishte me qenë edhe e padrejtë me ja marrë për të madhe partnerit, i cili kërkon për këtë aftësinë i cili posedon, një partner tjetër që është partner në kuptimin e fjalës, pikërisht këtu është fjala për shah. Sepse njeriu si i tillë është njëhershëm, i pa përsëritur dhe nuk mund ta zëvendësojë me as një njeri i tjetër në botë, po ashtu as me ndonjë shoqëri tjetër.. Me gjithat, kemi edhe lami, që i takojnë vetëm shoqërisë të meshkujve, si për shembull bisedimet për mbi financave, për politik ose për profesionin, ose lami që janë specifike për femrave, siç bie fjala moda, biseda personale për çështjet e personale, për sjelljen njërit ose të tjetrit



njeri. Këto janë lami e jetës së njeriut, që nuk mund t'i gjejmë në gjirin e martesës, dhe nuk mund partnerët vet t'i aktualizojnë ose t'i realizojnë në rrethin e një çiftit martesor.

Siç thotë fjala e vjetër:” gjithëcka mund të durohet dhe të përballohet në qoftë se ke miq”, edhe atëherë, kur nuk mund miku asgjë tjetër me të ndihmuar, por mjafton me të marrë për dore dhe me ta thënë një fjalë të bukur ose ngushëlluese.

Miku është si buka dhe vera - pasuria më e madhe, thesar i pashtershëm. Miku është ngushëllimi më i thellë në çdo nevojë. Ashtu miku është mirësia e parë njerëzore; nëpër mes miqve përjetohet shenjat e para mirësisë hyjnore.

Beso, se as ndonjë farë raportit punëtorit social, as i psikiatrit, ose ndonjë nëpunësit, as ndonjë ndihmë

e organizuar prej shoqërie nuk ka atë domethënie e vet, për njeriun që gjendet në brenga dhe në fatkeqësi të etheve të depresionit, frustrimit, moskuptimit, siç është vetëm një gjest i vogël i mikut ose mikeshës - dashamirit.

Një burrë telefonoi ditën e diell: "Jam i brengosur. Nuk dëshiroj të jetoj më. Gjithkund kamë shkua, siç më ka thënë të tjerët, jam ngop me psikiatrin dhe këshillat e tij, ashtu edhe me barnatoren dhe ilaçet që i kamë marrë deri tani, por mbetet gjithashtu si përpara, pa ndonjë përmirësim?"

Një grua ankohet: "As gjë mos më thuaj! Dijë vetëm të punoj marrishtë. I kamë katër fëmijë. Gjithçka kamë, por jam e mërzhitur me jetën time, nuk më jetohej më?"

A thua se nuk ka pasur, as ndonjë mikë, dashamirë, për me ju dhënë një siguri, njerëzve, çiftëve të martesës që dita ditës i tjetërson vetmia dhe i lëkund edhe kurorën e martesës?

Nuk mund të jetosh në qoftë se nuk e ke dikën që e donë, që kujdesohet për ty, që ndiejnë për ty, dikujt që herë pas herët mund t'i besosh dhe mundesh të mbështetesh në të, si edhe i i gëzohet ardhjes sate.

Në jetë do të vishë deri te takimi me shumë njerëz, por vetëm disa prej tyre do të hyjnë në jetën tënde, vetëm disa prej tyre do të mbesin dhe rriten në jetën tënde, vetëm atyre mund që t'i besosh gjërat e brendshme (. Është një bekim i madh për çiftin martesor me pasur në jetë njerëzit tillë, që janë dashamirët e tyre. Në mbrojtjen e tyre, e ndiejnë vetën të sigurt, si në shtëpinë e vet ashtu edhe në rrugë. Për ndryshe jeta e vetmuar e çiftit bëhet e pa mundur, monotone, e pakuptimtë, që fillon të tjetërsohet duke u zhytur në vetminë e shkretisë të pafund. Duhesh ta kuptosh, sa është e domosdoshme, që ta kesh vetëm një njeri në jetë, i cili në mënyrë spontane dhe me duar të hapura të pranon dhe të kupton. Sot fatkeqësisht është numri i madh i atyre që nuk kanë askënd, që dikush që kishte me u kujdesuar për çiftin që është në krizë, që ka filluar të lëkundet themeli i jetës së përbashkët, që cilët vetëm vrapojnë të avokati për divorc. Fatkeqësisht, nuk ka sish që mund t'i japin një pjesë së zemrës. edhe pse edhe zemra e tyre kanë brenga dhe shqetësime, edhe zemrat e tyre kanë nevojë për butësi dhe ngushëllime, përkrahjeje dhe ngrohësi: te dashamiri ose miku, çifti e tillë mund të strehohej, duke gjetur mbrojtjen dhe mbështetjen si edhe sigurinë shpirtërore dhe morale. Kjo velë veçanërisht edhe për çiftin që i kanë fëmijën, të cilët gjinden në burgun e shtëpisë, në qoftë se ata nuk kanë miq, dashamirë etj.

Për çiftin martesor, është mirë, që t'i kanë një ose më shumë miq, koleg ose dashamir, që mund çifti t'i vizitojnë, dhe bashku të diskutojnë për mbi problemet e jetës së përditshme. Do të thotë me jetuar vetëm në botë, si çift i vetmuar, dhe me u shoqëruar vetëm për

veten, kjo është një rrugë qorre, mënyra e gabuar e një çiftit, ndoshta është i sëmure ose nuk është normalë, sepse qëndrimi i tillë nuk është më garant, për një zhvillim të normalët të një çifti, as nuk është garanci që do ta ruajnë jetën e përbashkët të martesës, por shpejt do të vijë deri te kanibalizmi i jetës së përbashkët.

Domosdoshmëria për me pasur miq, dashamirë dhe lidhjet e shumta me shoqëri, me shokë dhe me dashamirë, është në të kundërtën terapia e familjes, çiftit martesor dhe automatikisht është edhe fara që mbjellët, dhe jep impulsin e çlirimit, prej gjitha preokupimeve që na kanë skllavëruar ose robëruar. I madh është numri i atyre njerëzve, të cilët e kanë nevojën për me u shoqëruar me shoqërinë e të njëjtës gjini, siç është nevoja për shoqërinë e meshkujve, ose atyre që kalojnë vetëm duke pi një kafe. Shpesh është kjo një shprehje e nevojshme të një primitivizmit, që njeriu kërkon një kënaqje të tillë siç është ajo e bixhozit ose e kafes. Çifti martesor i duhet, këto gjëra me i marr serioze, dhe me i lejuar në mënyrë të përgjegjshme siç është, shoqërimi i burri me shokët e vet dhe gruaja me shoqërorin e vet. Sepse, duhet njëherë dhe përgjithmonë ta kuptojmë se ne si njerëz, nuk jemi as një mënyrë engjëj, dhe as nuk jemi vetëm të përbërë prej shpirtit, por është teje e rëndësishëm, për ta kuptuar rëndësinë e mikut, mikeshës, dashamirit, pa i marrë parasysh pozitat e larta apo të ultë shoqërore, duke u shkarkuar nga mendësia primitive si dhe paragjykimet që e bënë njeriun viktimë i klasave, të ultë apo të larta, mos të themi se dikush është bajraktar apo drejtor, kryetar etj...! Megjithatë, është e domosdoshme me i dhënë përparësi takimeve me dashamirë, miq, vizitat herëpashershme në mënyrë reciproke, gjithashtu është e nevojshme lëshimet, siç themi me lëshuar pe, dhe sipas nevojë me qenë takimet e thjeshta, të përzemërta dhe të mirëseardhura, që shërojnë dhe jo helmojnë. Kënaqësia e takimeve të tilla ose vizitave, të cilat janë me plot nxitime. Këshillohen për terapinë e familjes ose çiftit, edhe shfaqet e përbashkëta, ose organizimet e përbashkëta, si bien fjala, bisedat e përbashkët në grupe senzibile ose dinamikës të grupit, që i përgjigjen jetës më elementare të njeriut, ashtu edhe shprehet solidariteti për shoqëri.

Në botën e krishterë organizohen ushtrimet shpirtërore vetëm për çiftet e martesës, në vendet e caktuara, posaçërisht, që i shërbejnë këtij qëllimit. Ndonjë organizim i përbashkët si në lëmin humanitare ashtu edhe at aktrimeve, vikendit etj.

Për njëshin ose individin, i cili ka nevojë për mbrojtje, edhe për këtë gjë është prapë tubimi i përbashkët ose vizita miqësore të mikut ose dashamirit e ka atë funksionin pozitiv dhe shpëtimprurësi terapeutik, edhe deri sa kjo nevojë ekziston, edhe kishte me qenë mendjelehtësi për çiftin

martesor për ta diskualifikuar, shoqërinë, miqësinë, organizimet e përbashkëta etj. Nuk është nevoja, që çiftit t'i imponohet (dhunohet) ose t'i urdhërohet, në rastet e tilla preferohet spontaniteti dhe natyrshmëria: miqësia, shokët, dashamirët dhe ndërmarrja e përbashkët. Por është shumë e rëndësishëm që t'i respektojnë nevojat njëres dhe tjetres palë, dhe t'i njohin edhe llojshmëritë, se njeriu si individ nuk është reproduksioni i një kopjes, por personalitet, subjekt unikët, i njëhershëm dhe jo i përsëritur me ato vetit tipike dhe karakteristike që i bart njeriu me vete. Ashtu është e rëndësishëm, takimet dhe vizitat i tilla, se sa me ardhur deri te ngarkesat e panevojshme. Zemërgjerësia e tillë e supozon se nuk do të vijë deri te keqtrajtimi, ose keqpërdorimi, në damë të jetës së përbashkët, edhe faktikisht deri te lërja e pas dorës: bashkëshortin ose bashkëshorten, atëherë, siç pohon Christa Meves, vetvetiu vejnë shërri edhe më i madh, që i themi tjetërsimi ose ftohja e çiftit martesor në qoftë se keqpërdoret besnikëria dhe besimi i mikut, mikeshës, dashamirit.

I. Qëllimi i jetës shprehet në raportin me tjetrin

Për t'ia arritur një harmonisë normale të bashkëjetesës në gjirin martesor, atëherë duhet pikë parit partneri ta posedojë harmoninë e brendshme, e cila reflektohet ndaj partnerit tjetër. Vërtetë se në mënyrë teorike është fjala për dy njësi (subjekte), të cilat praktikisht kanë nevojë njëri për tjetrin dhe janë të lidhur ngushtë mes vetes, me një fjalë atyre u nevojite dialogu i përhershëm. Siç pohon John Grey : "Meshkujt vinë nga Marsi kurse femrat nga Afërdita."

Çdo njeri e bartë me veten tharmin e bisedës, ose nevojës për t'u shfryrë, shprehur ndjenjat e brendshme, ose përvojat qofshin ato të hidhura qofshin ato të mira (Nuk ka ditë pa natë, as natë pa ditë). Sepse njeriu nuk bënë as t'i shtypin as t'i mohojnë por t'i shprehin atij tjetrit. Nganjëherë nuk mund t'i shprehin partnerit të jetës burrit (gruas) por ka ndonjë mik që shumë më lehtë i'a beson botën e brendshme.

Po ashtu njeriu bartë me veten mundësin e korrigjimit, të zhvillimit, të përparimit si dhe të ngecjes. Për këtë ai, në rrethanat e ndryshme reagon po ashtu ndryshe. Përkatesisht në këtë pikë lajmërohet edhe pengesat. Si të tejkalohet problemi i shfaqur dhe njëherë mos të lëndohet partneri, i cili mund lehtë të humbin besimin në partnerin e vet po qe se ky fillon t'i besojë atij tjetrit dhe jo partnerit që e ndanë fatin e jetës me të?

Të gjitha pjesët e fshehura të njeriut janë të ndërlidhura njëra me tjetrën, por të gjitha varte pikërisht nga vetëdijesimi ose ndërgjegjësimin e

individit si dhe liria për të vendosur. Kuptohet liria në kontekstin tonë është liria e brendshme e njeriut e cila tërheqë pas vetes edhe përgjegjësinë e plotë çdo lloj veprimit që e ndërmerr individi.. Po qe se individi arrit njësimin e plotë të vetvetes si dhe vetëdijesohet për situatën, atëherë ai është edhe që këtë proces ta shpien në shërbimin e tjetrit, në këtë kontekst burri është në shërbimin e gruas si dhe gruaja në shërbimin e burrit. Nga ky aspekt do të zbutet zilia apo mosbesimi ndaj partnerit.

Në fund të fundit është edhe një pyetje tjetër: se si të harmonizohet ky raport. Kuptohet se recete të gatshëm nuk ka, por mund t'i japim disa drejtime si dhe këshilla për të kërkuar zgjedhjen. Kur personi nuk është i aftë t'i njësojnë të gjitha pjesët e veta në një tërësi të vetëm të personalitetit, atëherë nuk mund të flitet për një dashuri të pjekur, sepse individi i tillë është i nxitur nga çdo veprim që bënë partneri i tij. Atë e udhëheqin jo më arsyeja e mendjes por emocionet, po qe se emocionet janë të forta, atëherë nuk mund t'ia arrin deri ta një pamje të qartë, ndërsa dashuria e tij mbetet në suazat e një personit të shkatërruar, i cili nuk mund do ta marrin timonin e jetës në duart e veta.

Ndërsa në të kundërtën, fjala është për personin e integruar, të pjekur, të vetëdijshëm ose të ndërgjegjshëm, i cili posedon unin, veten si dhe merr përgjegjësinë mbi vete. Me një fjalë e ka timonin e jetës në duart e veta. Kuptohet vetvetiu se nuk arritet për krye nate një pjekuri dhe një tërësi e tillë, por kuptohet duhet kohë.

Njeriu me njësimin e plotë të brendshëm, realizohet si dhe aktualizohet ngadalë, edhe pse është gjithëherë në tundime, qofshin të brendshme qofshin ato të jashtme, që duan ta tjetërsojnë harmoninë e arritur. Për këtë duhet individi, i cili arriti i njësojnë të gjitha elementet e veta në një tersin të një personalitetit të vetëdijshëm si dhe të ndërgjegjshëm, të jetë gjithëherë vigjilent. Për këtë do t'i ndihmojnë shumë shkencat mbi njeriun (medicina, biologjia, psikologjia, sociologjia, pedagogji, teologjia etj.), për ndryshe nuk mund të kursehet nga tundimet e përhershëm që e ndjekin si hija e zezë gjatë rrugës së martesës, bile deri në vdekje.

Tërësia e individit nuk është vetëm kusht për një dashuri të pjekur dhe të përgjegjshëm, por me këtë e ruan si dhe ripërtërihet nga brendia e tij. Sepse ndërtesa e njeriut nuk është asgjë tjetër përveç dinamika, e cila është autentike aq sa personi vetëdijesohet mbi veten. Në këtë drejtim mund të themi njeriu është aq i njësuar si dhe zhvillohet ka individi i plotë, sa di të dhurohet falas tjetrit. Për këtë është e rëndësishëm miku, dashamirët, nëpër të cilëve kanalizohen shtypjet, brengat, krizat, monotonia, vetmia, frika, ankthi, pasiguria si dhe rutina e jetës së përditshme.

Giovani Cucci S.I.-Massimo Marelli S.I

USHTRIMET SHPIRTËRORE TË SHËN INJACIT: NJË PROPOZIM AKOMA I VLEFSHËM?

(Pjesa e parë)

Një eksperiencë e panevojshme ?

Në jetën e përditshme, jeta shpirtërore dhe orët e kaluara në tërheqje shpirtërore, sikur ndodh në Ushtrimet Shpirtërore, konsiderohen si një humbje kohe dhe energjie, pasi këto energji ne mund t'i përdorim për realizimin e aktiviteteve më të dobishme e fitimprurëse; ndërkohë që të tjerë, kërkojnë që t'u bëjnë të « ndiheni mirë », për të fituar atë qetësi, duke ndjekur një jetë të lumtur. Kush i është futur kësaj eksperience duke ndjekur udhëzimet këshillat e Shën Injacit, vëren saktësisht të kundërtën. Madje edhe në termat operacionalë.

Duke matur distancën nga situata vetjake, e konsideruar si e domosdoshme nga Ushtrimet, të bëjnë gjithnjë mirë. Thomas Merton vërente se jeta e brendshme, duke e konsideruar atë si asketizëm, si praktikë shpirtërore, është në bazë të angazhimit e të pjesës më të madhe të transformimeve sociale të ndodhura gjatë historisë. Eksperiencia mëson se, kur mësohesh të “shkëputesh”, ose të operosh si një ndarje nga ajo që na mban të lidhur me veten, të bën më efikas, por më së shumti fitohet në shëndet edhe në profilin intelektual.

Një eksperiment i bërë nga David Strayer, i universitetit të Utah, mbi një grup burrash e grash, rreth moshës 30 vjeçare, ka treguar diferencën e madhe të rendimentit dhe të kapacitetit përballë detyrave të kërkuara, kur personat përfitojnë te një periudhë e një stakimi total prej katër apo pesë ditësh, prej çdo aktiviteti, që ka të bëjë me punën, por edhe me çdo lloj instrumenti teknologjik. Diferenca në kushtet e krijimit ishte më e konsiderueshme nëse periudha e shkëputjes ka qenë e kaluar në kontakt me natyrën.

Larg asaj për të qenë një manifestim i tjetërsimit e i braktisjes së realitetit (siç pohojnë të ashtuquajturit “mjeshtrit e dyshimit”, Max, Nietzsche, Freud), dimensionin shpirtëror, që ka si referent të privilegjuar heshtjen dhe kontaktin me natyrën dhe me botën e brendshme të vetvetes, (kushtet që duhet të plotësohen për t'u hapur shpirtërisht në takimin me të tjerët, duke filluar nga vetë ndërgjegjja jonë), rezulton si një ndihmesë e dyshim për ekuilibrin e zakonshëm psikologjik të personit.



Për këtë, Shën Injaci fton praktikuesin për t'u diferencuar edhe fizikisht nga jeta e përditshme, që të mund ta plotësojë sa më mirë këtë eksperiencë: kuptohet, kush bën të tilla ushtrime ka shumë më tepër rezultat kur distancohet nga miqtë, të njohurit dhe të çdolloj shqetësimi material. Për shembull, mund të ndryshoni shtëpinë e të transferoheni në një shtëpi apo dhomë tjetër për të jetuar me mikpritjen më të mirë të mundshme; kështu do ta kenë më të lehtë që të merrni pjesë çdo ditë në meshë, pa pasur frikë se mund të shqetësoheni nga të njohurit. Nga ky izolim dalin, mes shumë të tjerash, 3 përparësi të rëndësishme. E para, kush shkëputet nga

shumë miq e të njohur dhe nga shumë punë që nuk i kemi vendosur në vijë, për t'i shërbyer e lëvduar Zotit, Zotit tonë, fiton një vlerë të madhe përballë Tij. E dyta, kush është kaq i distancuar, duke mos e pasur mendjen është i shpërqendruar në shumë gjëra, por që e përqendron të gjithë vëmendjen në një të vetme, pra për t'i shërbyer Zotit dhe për ta gjallëruar në shpirtin e tij, mund ta marrë më lehtësisht potencialin natyror për të kërkuar me zell atë që shumë dëshiron. E treta, sa më shumë që një shpirt të gjendet i veçuar, aq më shumë bëhet i zoti t'i afrohet e t'i bashkohet Krijuesit të tij; e sa më shumë që i afrohet, aq më shumë është i disponuar të marrë lavdi e të mira nga mirësia hyjnore.

Të “stakohesh” nga ambienti e aktiviteti i zakonshëm konsiston në të hyrit në botën vetjake të brendshme e të shikosh më mirë atë të jashtmen; është si të vëzhgosh një qytet nga lart: aty shikohet në brendësinë e tij, në tërësinë e tij, gjë e cila nuk është e mundur kur je i përfshirë. Te “Ushtrimet” përfshihet në një mënyrë më të qartë dhe të dallueshme ajo që jetohet në jetën e zakonshme, por në një mënyrë të fshehtë: mijërat aktivitete shpesh herë janë një mënyrë për të fshehur boshllëqet dhe vështirësitë e të jetuarit, duke bërë që të jetohet kështu në një mënyrë sa më të shurdhër. Duke matur distancat e aktivitetit të zakonshëm, duke rilexuar fjalën e Zotit, ndihmon për t'u rikthyer me më shumë efikasitet, duke ditur atë që po kërkon, por mbi të gjitha se si ta njohësh këdo që e gjen. Kur është kurajoja, pasi

jeta shpirtërore nuk është një arratisje, por një luftë me vetveten, të përballosh e rilexosh sa buron nga brendësia e vet, vërehen disa rënie themelore të jetës së vet. Për këtë, eksperiencia shpirtërore është baza e ndryshimeve të mëdha, si individuale ashtu edhe historike.

Rëndësia e kurës së vetvetes

Jeta shpirtërore nuk është një flluskë kalimtare sugerimesh, krejt e kundërta, ka ligjet e veta, rregullat e veta, që gjenden në fillimin e eksperiencave të mëdha të mistikëve dhe të mësuesve të jetës shpirtërore. Shkrimet e tyre tregojnë një njohje, një vizion të jetës, të njeriut e të Zotit. Mbi të gjitha, ndihmojnë të rinjohin zërin, për të qenë gjithnjë e më shumë i pranishëm në projektin e tij, të tensionuar në një jetë të plotë.

Mësimi i parë i Ushtrimeve është ky: të mësohesh të edukohesh me këtë stil jetese, duke u ruajtur nga rreziku i fatalitetit, të nihilizmit, të mospërfilljes. Këto kanë të përbashkët mungesën e një pune në aspektin më vendimtar, mbrojtjen e vetvetes, të dimensionit të vet të brendshëm, e cila lihet mënjatë lehtësisht, me pretekstin se kishte të bënte me një lodhje të kotë e nuk do të çonte në asnjë ndryshim. Përtacia e vesit të shkëputjes, tani është kaq shumë e përhapur dhe e zakonshme, pasi reflekton mungesën e besimit në një dimension më të madh të projekteve dhe realizimeve tona. Jetohet të ancoruar me të sotmen, në çast, e kjo, mund të krijojë iluzionin e një fuqie të vetme, të të pasurit gjithçka në duart tona, megjithatë prezantohet një çmim i lartë për t'u paguar.

Të krijosh një iluzion se mund të programosh jetën tënde, është si të shtrëngosh në duart e tua një zog, për ta pasur gjithnjë me vete: në të vërtetë, përfundon duke e mbytur. Në të njëjtën mënyrë, jeta fiket kur rrafshohet në nivelin tonë të konsideratës dhe projekteve, duke u bërë shpejt e zbrazët dhe e trishtuar. Mungesa e shprehës është një shenjë alarmuese, kujto se është zbehur dimensionin i jashtëzakonshëm i ekzistencës. Në të tillë rast, përballë vështirësive të pashmangshme dhe aksidenteve që na karakterizojnë, përfundon në pyetësorin nëse ia vlen të përkushtohemi dhe të luftojmë për diçka që nuk paguhet fill. Pikërisht ky është zëri i përtacisë, një zë bindës: përse të rrezikosh për diçka që ndoshta nuk do të ndryshojë asgjë në jetën tonë?

Përtacia e mund vështirësinë për t'u marrë me zgjedhjet e jetës, thelbësore ose afatgjata, për ta luajtur lirinë për diçka që ia vlen, mbi të gjitha duk iu afeksionuar asaj që bën: “Në botën tonë, përtacia nuk ngjan më me dembelinë; por me atë të thellimit.”. Thuhet “të gjithë janë njësoj dhe për t'u përmirësuar është e pamundur”. Kjo mënyrë e të arsytuarit, eviton të vendosurit në dyshim të vetë dënimit... Përtacia nuk di të lodhet. Mbi të gjitha nuk mund të përkushtohet. Në kohën tonë ka burra, të cilët nuk dinë të kultivojnë gjatë as një dashuri. Thonë: “Çfarë mërzie!”. Ushtrimet shpirtërore nuk janë një tekë e atyre që nuk dinë sesi të kalojnë ditën e tyre. Janë një ndihmesë e çmueshme për të ndihmuar për të jetuar mirë. Për këtë janë edhe të lodhshme, pasi shikojnë se si të riformojnë

personalitetin e tyre. Çelësi i fitimit është shpëtimi, e cila që tani përkthehet në plotësinë e jetës

Një propozim i integruar

Kërkesa, vendoset në fillim të “Ushtrimeve Shpirtërore”. Të “vendosurit rregull” përbën një risk tjetër të madh për jetën shpirtërore: tendenca për të ndërtuar një besim sipas imazhit të vet dhe ngjasimit që mendon, duke evituar atë që është e parehatshme ose na shkakton bezdisje: e një lloj supermerkate e shpirtit, ku mund të selektosh atë çfarë të pëlqen, duke anashkaluar atë që mbetet. Termi “shpirt” i lidhur me Ushtrimet, na çon në një të qenë i gjallë, jo si një menu, apo një listë produktesh për t'u zgjedhur sipas shijes së momentit. Eksperiencia e besimit, pikërisht në këtë krahasim me një organizëm të gjallë, prezanton një koherencë të veten dhe një unitet të vetin, që nuk janë të negociueshme për qejfin tonë, siç na kujton Papa Françesku: “Duke qenë se besimi është një i vetëm, duhet të rrëfëhet në të gjithë pastërtinë dhe integritet. Pikërisht pse të gjithë artikujt e besimit janë të lidhur me bashkimin, të mohosh një ndër to, edhe të atyre që në pamje të parë duken më pak të rëndësishëm, është e barabartë me të prishurit e gjithçkasë. Çdo epokë mund të gjejë pika të besimit nga më të lehtat te më të vështirat, për t'u pranuar: për këtë është e rëndësishme që të jemi të kujdesshëm, pasi transmetohet e gjithë depozita e besimit, për atë që insiston mbi të gjithë aspektet e të të rrëfyerit të besimit. Në fakt, në këtë pikë të besimit është uniteti i kishës, t'i hiqet diçka besimit do të thotë është që t'i hiqet një e vërtetë bashkësisë. Etërit e kanë përshkruar besimin si një trup, trupi i të vërtetës, me lëkurë të ndryshme, në analogji me trupin e Krishtit dhe me zgjerimin në kishë. Integriteti i besimit është i lidhur edhe me imazhin e Marisë, në besnikërinë spontane ndaj Zotit: të thyesh besimin do të thotë të thyesh bashkësinë me Zotin. Bashkimi i besimit, është pra ajo e një organizmi të gjallë, siç ka treguar i lumi John Henry Newman, kur numëronte nga shënimet karakteristike për të dalluar vazhdimësinë e doktrinës në kohë, fuqinë e tij për të asimiluar në vetvete gjithçka që gjen, në zonat e ndryshme në të cilat shfaqet, në kultura të ndryshme që takon, duke purifikuar çdo gjë e duke na çuar në shprehjen e tij më të mirë. Kriteri i referimit për dimensionin shpirtëror nuk është ajo e modës së momentit, por më së shumti ajo e shëndetit dhe e kurës së nevojshme për ta mbajtur. Në karrigen terapeutike, një ndërhyrje kirurgjikale rrallë herë mund të konsiderohet e këndshme, por ndonjëherë është thelbësore për jetën. Një qenie e gjallë është karakterizuar nga një strukturë e bashkuar: nuk mund të selektohet në jetë, duke zgjedhur atë më të pëlqyerën për ta ngjitur diku. Kështu krijohet një model, që kur lidhet me jetën, edhe pse propozimet e shumta janë kontradiktore dhe kërkojnë një zgjidhje, ato nuk mund t'i delegohen emocionit apo ndryshimit të humorit.

“Edhe në brendësi të atij 85% që në sondazhe deklarën të besojë, është gjithnjë e më shumë e përhapur

besimi “në vetë botën” (jo si një praktikë besimtare, jo si rrëfim, po si tolerancë ndaj moralit të dyfishtë të disa politikanëve (në të njëjtën kohë katolikë dhe racistë, besimtarë dhe jetues të mirë) në thellësitë e thirrjeve (...). Humbet “frika e Zotit” (në mungesë të të cilit gjithçka bëhet mundësisht e lehtë), edhe mbi çështjet e besimit (pas asaj të politikës), jemi sulmuar në masë nga një status i papjekur, e një instikti të vërtetë, narcistik, që i referohet rregullave”.

Ushtrime dhe bamirësi

Pas rezistimeve të kujtuara më lart mund edhe të fshehet zbehja e disa aspekteve thelbësore të jetës: dimensionet e bamirësisë dhe të bujarisë. Ato janë edhe çelësi i pranimit ndaj eksperiencës së Ushtrimeve, siç na kujton vetë Injaco. Bamirësia ka një vlerë kontestuese të mentalitetit komercial, të dobishme për ta konsideruar besimin. Si na rrëfen p. Ugo Sartorio: “Nuk është e rëndësishme që besimi të jetë i vërtetë, duhet të jetë mbi të gjitha i dobishëm; pra të jetë i aftë që të formojë te subjekti vitamina esenciale për të mbijetuar pas kaosit të botës moderne. Shpëtimi që preokupon (...) është ai që ka të bëjë me integritetin e vet psiko-fizik, është një nivel i lartë i vetëkënaqësisë personale. Shumë besimtarë, ose më mirë të themi të besimit miksi të improvizuar nga roja e vetë unit, shpesh herë duke paketuar trashëgiminë simbolike të shumë traditave-, presin këtë gjë dhe jo tjetër.

Nga këtu lind varfëria e brendshme, pamundësia për t'i jetuar reagimet, edhe në kontekstin e eksperiencës së besimit. Për këtë gjë, tradita kristiane gjithnjë ka insistuar në rëndësinë e shoqërizimit si një moment i pazëvendësueshëm i leximit të së vërtetës së mundshme të rrugëtimit të vet. Shpirtërorja e krishterë nuk mund të ngatërrohet me propozime të tjera, si *new age*, të tensionuara thjesht me “të qenit mirë” dhe me të pëlqyerit. Në fakt, përfundohet duke ndodhur krejt e kundërta, sa më shumë që kërkohet mirësia dhe kënaqësia, aq më pak gjehet. Sensi i plotësisë dhe i paqes së brendshme të jep qetësi, në një mënyrë të papritur, si në eksperiencën e Zotit, që ka theksuar Injaco, e më zakonisht në tregimet evangjelike të vokacionit: Zoti gjendet kur nuk e kërkojmë. Vetëm në bamirësi, të eksperimentuar dhe të ofruar, të pavarur ndaj limiteve, defekteve dhe pamundësive, ftohen miqtë për të plotësuar të mirën, e jo për t'u shikuar e vëzhguar, pasi e vërteta e vetme është ajo e Atit, dhe kjo mund të jetë vetëm një sekret dhe në momentin në të cilin nuk kërkohet: kjo është lumturia e bamirësisë.

Kuptimi i kushteve

Shprehja “Ushtrime Shpirtërore” nuk është shpikur nga Injaci. Ai rimerr në shqyrtim një traditë shumë antike, pikërisht atë të shpirtërores së krishterë të shekujve të parë, që në kohën e tij u tërhoqte nga filozofia greke. Sipas traditës stoike, “Ushtrimet Shpirtërore”, sipas dialogut platonik, ishin skanuar nga pacienti duke dëgjuar dhe konfrontuar me një guidë që ishte e aftë t'i jepte zë ndjenjave të jetuara, vendosjes në lojë dhe

rezeqeve të mundshme, duke ndihmuar individin që të njohë dhe aktualizojë këtë që mund të vazhdojë: “Ky është mësimi i filozofisë antike: një ftesë për çdo njeri për ta transformuar vetveten. Filozofia është bashkëbisedim, transformim i mënyrës se si është dhe e mënyrës se si jeton, kërkim i dijes. Nuk duket edhe aq e lehtë”. Mbi këtë çështje ekziston një vazhdimësi e fortë mes traditës klasike dhe krishterimit: ato janë bashkuar nga një dëshirë për të njohur vetveten dhe të operojnë njohje urtësie, e aftë që të bashkojë dimensionet intelektuale dhe afektive. “Ushtrimet Shpirtërore” merren nga Injaci në këtë çelës praktik, siç ai na kujton në tekstin: “Ushtrime Shpirtërore” për të fituar ndaj vetvetes e për të vendosur rregull në jetën e vet pa marrë vendime në bazë të ndonjë afeksioni që është i turbullt. Bëhet fjalë të mësojmë që të zbatojmë vendime “të pastra”, në kuptimin, të para nga lart, të ëmbla ndaj vullnetit të Zotit. Në këtë mënyrë, tërheqja, në një kohë të fortë për shpirtin, bën që të ndihen pasojat e saj në jetën e zakonshme, pasi është “e shënuar qartë përgjatë jetëgjatësisë së përgjithshme, përcaktohet një fillim dhe një fund”.

Tekstet e shumta të sjella nga Pierre Courcelle, ku në përpikërinë e tij është i detajuar studimi mbi këtë temë, duke konfrontuar integritetin e thellë mes refleksionit filozofik dhe atij biblik, një dialog i bërë mbi të gjitha me respekt dhe njohje nën kujdesin e autorit, i cili ka mjaft për të thënë në debatet e sotme mbi mundësinë e lidhjeve mes kulturës laike dhe besimtare, duke reduktuar shpesh diskutimin drejt etiketimeve boshe. Ripërshkon historinë e mendimit, duke i studiuar burimet, tregon në të kundërt, pika të përbashkëta shumë të vështira për t'i kundërshtuar, figura studiuesish të cilët dëshira për të njohur rezultoi më e rëndësishme se sa frika ndaj ndryshimit. Pika që bazohet çdo dialog, edhe gjatë takimit me Zotin, mbetet njohja e vetvetes: “Çdokush që dëshiron ta kërkojë Zotin e ta gjejë, duhet ta kërkojë te vetvetja, në fundin intim të shpirtit të tij, aty ku gjendet imazhi i Zotit, dhe i duhet të gërmojë në kampin e ekzistencës së tij të krijuar.”

Edhe një tjetër element thelbësor i shpirtërores injaciane, ushtrimi i ndërgjegjes, ka origjinë shumë të lashtë. Shën Çezari i Arles, në predikimet e tij, ftone dëgjuesit drejt kësaj praktike, për t'i pastruar zakonet e këqija, të njohura nga veprimet e zakonshme, duke transformuar vetveten dhe duke u bërë sa më konform me imazhin e Zotit, prezent në çdo njeri. Konfrontimi me vetë natyrën bëhet kështu, ngadalë, gërmues i vetvetes, si në punën e fshatarit, një lodhje e paimagjinueshme, sepse jeta e tij mund të sjellë frytin: “Të gërmosh në këtë rast do të thotë të hetosh ndërgjegjen tënde, të vëzhgosh me kujdes mendimet tua, gjuhën tënde, veprimet tua, të heqësh dorë nga të gjitha veprat të drejtuara nga trupi, të eliminosh përmes ngrohtësisë së rrëfimit, të mbjellësh frytin e shpirtit, duke barazuar në burimin e ujërave të gjallë, pendimin dhe lutjen”.

Përktheu: Bernardina Shahini
Material i përkthyer nga revista kulturore –
fetare “La civiltà cattolica”, 2019.

Zija VUKAJ

HOMAZH PËR MIGJENIN

108 vjet më parë, më 13 tetor 1911, u lindi Migjeni, në mëhallën Gjuhadol të Fretënve në Shkodër. Dje me 12 tetor, 2019, nga organizatorët Dom Nikë Ukgjini, Dom Kristian Marku dhe afaristi Gjergj Leqejza, në praninë e studiuesve u rivendosë pllaka memoriale në shtëpinë ku banoi poeti. Në nderim të tij mund të bëhen shkrime të ndryshme, por unë preferova të botoja për këdo që ka durimin të lexojë këtë studim timin modest dhe tejet personal për dyproza të tij.

"KAPËRCIM LOGJIK"**"Nga vetvrasja te "kanga" e trumcakut**

Në skicën "Vetvrasja e trumcakut" ndeshemi për herë të parë në letërsinë shqiptare me surrealizmin. Brenda hapësirave të vogla të këtij etydi autori ka marrë pozicionin e krijesës dhe të Krijuesit. Drama e trumcakut është tragjedi. Tragjedi moderne ekzistenciale. Procedimi artistik është sa surreal, aq edhe i guximshëm. Vetë autorit i duket e parakohshme për nivelin e lexuesit shqiptar, sepse fut fenomenin e kapërcimit logjik, që me sa duket është togfjalëshi më i saktë dhe i përshtatshëm për të shpjeguar fjalën surrealizëm, i pabindur mirë nëse do të kuptohet dhe ndërgjegjja e tij prej krijuesi tej pamës zbret në nivelin e shpjegimit të tekstit të vet: (Çka janë këto kapërcime logjike? Ka me bërtitë ndokush.) "Mos pyesni si e tek u gjet trumcaku n'at vend dhe si e tek u gjet njeriu në këtë pikë kozmike; nuk dijmë shumë. Hipoteza dhe andrra. Miliona vjetësh dhe një fjalë goje, si për shembull: "... t'bahet dritë! Dhe drita u ba!"- A e shifni? Një fjalë magjike! Hokus- pokus! Sa bukur! Dhe unë thashë: të lindet trumcaku në një vend, ku në vend të barit bijnë qimet e derrit e në vend të pemve-brinat e një kafshe prehistorike."

Këto dy nivele krijimi: Zoti krijoi Migjenin dhe e vendosi ku deshi ose e flaku në një pikë e çdo të kozmosit, ky krijoi trumcakun dhe e vendosi ku deshi ose e flaku në një antitotë, që nuk ofron asgjë, madje as aq sa i duhet një trumcaku për të jetuar; që të dyja arbitrare (sipas autorit), realizuar nga Zoti i madh dhe zoti i vogël, shprehin edhe kredon filozofike, thelbin dhe vijën ndarëse mes dy degëve të ekzistencializmit dhe unisonin e

autorit me bashkëkohësit e vet evropianë, përfaqësues të ekzistencializmit ateist, që krijuan realitete artistike, si ai i "Procesit", "Metamorfozës" "Murtajës" dhe personazhe si Jozef K, Merso, Gregor Zamza etj., të zhytur në qerthullin fatal e pa rrugëdalje të jetës. Fatalitet ose ironi e fatit, që paralajmërohet edhe nga mbititulli "Rrota e jetës".

Antimaterien artistike autori e ka vizatuar me dy penelata, që janë të mjaftueshme për të dhënë të plota dimensionet e ferrit social (natyra që nuk mund të quhet natyrë): qimet e derrit dhe brinat e një kafshe prehistorike, sepse kjo prehistoria është



torturuese për autorin futurist në të gjitha kuptimet, kurse trumcaku jepet që në fillim i humanizuar, pra një qenie sociale (bëhet melankolik). Në këtë habitat infernal, të denjë për vegimin dantesk, luhet drama e individit që nuk ka asnjë shpëtim dhe robinsonada e tij është e paralajmëruar të dështojë pa nisur. Loja simbolike është tepër e thjeshtë, gati pa nëntekst, sepse gjithkush e di se cili është trumcaku dhe vendi apo fati i tij (thujse autobiografi), por edhe këtu kemi Migjenin çmitizues. Pse trumcaku? Një zog pa simbolikë, pa romancë, pa lavdinë e shqiponjës apo të albatrosit, pa zymtësinë e korbit apo kotësinë e sorrës, pa muzikën e bilbilit apo të laureshës, pa misterin dhe bukurinë e pëllumbit, pa krekosjen e gjelit. Pa ngjyra të ndezura. Pa asgjë mitike. E zakonshmja dhe e përditshmja vetë, por më konkretja, më e besueshmja, individi mesatar. Mimetizmi, si dukuri biologjike, bëhet aleati i autorit. Ambienti të jep ngjyrën e vet të murrme, aspak romantike. Por trumcaku është gjëja më e vërtetë, ajo që të bind më shumë, tipikja, e përgjithshmja, e zakonshmja, modestja. Kësisoj është drama e vërtetë sociale. Ndërsa vetëvrasja, përveç revoltës, ka ndër të tjera dy aspekte: së pari, është një vetëvrasje që kufizon me heroizmin, me respektin e individit ndaj vetes. Reagim ekstrem dhe fatal. Si e tillë kthehet në tragjedi: cicroi një herë, cicroi dy herë, cicroi tri herë. Mandej një crrrr e gjatë e plot mallëngjim ishte porosia e tij e fundit. Testamenti i dhimbave të tij. Mos vallë cicrrimat e tij janë akoma çastet dilematike para vetvrasjes; apo piskamat dhe klithjet alarmuese që vajtojnë dhe akuzojnë këtë realitet dhe që duhen transmetuar diku. Mbase edhe një lloj egoizmi për të mos ikur pa u vënë re dhe një lloj përmallimi për jetën e humbur. Klithma e fundit, e gjatë, me jehona kozmike, që del nga shpirti i autorit, kumbon thekshëm në çdo shpirt, si një testament tragjik. Aspekti i dytë, prapë çmitizues, ka të bëjë me kundrimin e kësaj vdekjeje si diçka cinike. Më së shumti një hara-kiri. Një bjerrje e heroizmit, që jepet nga pamja e erës që luan me puplat e trumcikut të ngulur në heshtëqime derri, që sillet si gjeli metalik sipër oxhaqeve tona. Ja sa vlen heroizmi. Këtu, duket sikur na thotë autori, s'ke si të rrosh dhe s'ke si të bësh as edhe një veprim të denjë edhe po sakrifikove jetën. Në finalen e këtij teksti Migjeni duket sikur ndihet i shqetësuar nga ashpërsia me të cilën ia përplas lexuesit këtë absurd dramatik deri në grotesk dhe në mënyrë empatike tenton ta zbusë impaktin që krijon realiteti artistik, por edhe procedimi i tij surreal. Pra gjakon ta fusë edhe lexuesin e nivelit mesatar në zonën e double coding-ut të tekstit, për ta

“miqësuar” me kapërcimin logjik: “Po, lexues i dashtun e jo i cekët. Po! A pak po kemi kapërcime logjike, morale dhe dogmatike në botën tonë reale? Pse po zemrohe dhe po don me më gjykue për disa kapërcime logjike aspak damsjesse?” Dhe siç duket, këto kapërcime logjike janë logjika e vetme dhe më efikase për të kumtuar përmasat e vërteta të skenës dhe të personazhit. Ç'mund t'i themi këtij teksti? Fillim i një veprë të gjatë e të madhe? Thjesht, skicë? Kapriçio? Pikturë? Apo shpalosje sintetike e një pjese të kredos filozofike të autorit? Sepse motivi i trumcikut është rimarrë në një tjetër kohë, me gjykime më të zgjeruara dhe alternative e mbase edhe më të thelluara, te dorëshkrimi “Kanga e trumcikut”. Megjithëse dorëshkrimi i mungon faqja e parë, nuk është e vështirë të merret me mend ajo çfarë mund të jetë trajtuar në tekstin e munguar. Këtu kemi evoluimin e personazhit, që nuk e merr vetëvrasjen si të vetmen alternativë. Në rastin e vetvrasjes konflikti është me botën që e rrethon, me natyrën që s'është natyrë dhe jeta është e pamundur. Por tek “Kanga e trumcikut” jepet apo sprovohet alternativa e jetës. Dhe konflikti më së shumti është me veten. Në tekstin e munguar autori duket se e ka quajtur trumcakin e vetvrasë pa fat, sepse në fillim të dorëshkrimit të mbetur autori shprehet: “... i lodhun dhe ma i pakënaqun trumcaku me fat, qëndron mbi degë. Me urrejtje shikon natyrën që s'e krijoi ma artistikisht. Me përbuzje vërente bilbilin.” Në ballafaqimin me fatin apo fatalitetin e vet, (pse trumcaku asht trumcak e nuk mund ta thotë kangën e bilbilit), trumcaku i “kangës” është shndërruar në një filozof jete. Por në një filozof dinak e pragmatist, “cinik e faqezi.” Sokrati i vuajtur është bërë gati një derr i kënaqur: “...trumcaku filozof e mundi trumcakin harbut.” Në këtë zhvendosje ontologjike, nga vetvrasja te kanga, Migjeni ruan kohezionin e një gjykimi në zhvillim, duke na shfaqur metamorfozën e individit të kushtëzuar nga nevoja për mbijetesë, përballjen e fatalitetit duke bjerrë me vetëdije idealizmin e tij dhe vlera të tjera, pra duke “kënduar” këngën banale të jetës së vet dhe duke iu nënshtruar paktit me djallin. Por këtu vjen paradoksi: për t'ia arritur kësaj duhet edhe një milion vjet. Një e ardhme e largët. Ndërkohë që ne e mendojmë të ardhmen si shpresë drejt përsosjes së individit, ajo na projektet si stërmundim i gjatë drejt shpërbërjes së modelit nëpërmes një evolucioni që ecën së prapthi. Pra, nëse duam të jetojmë në natyrën që s'është natyrë, të mos vetëvritemi dhe të mos ua kemi zili njerëzve që na rrethojnë, duhet të mësohemi të këndojmë këngën e shpërfytyrimit.

Mergim KORÇA

**“NJË JETË E SHKRIRË PËR FÉ E ATDHË”,
KUSHTUAR MONSINJOR DR. ZEF OROSHIT**

Për herë të parë i a kisha dëgjuar emrin shumë dhjetra vite të shkuara e pikërisht në verën e vitit 1953, kur zoti Loro Kovaçi na thotë, të birit Toninit si edhe mua, se ... është arratis'e ka dalë në Jugosllavi Dom Zef Oroshi ... aj është pënd'e fortë e ka me i a diftue botës të tana krimet qi janë kah i përfton këtu te na kjo diktatur'e mallkueme komuniste! Ne përjetonim vitet kur Shqipëria ishte i vetmi vënd, i ashtuquajtur socialist, ku akoma vazhdonin e vepronin çetat e malit që luftonin për lirin'e vëndit! Me këtë rast marr lejen e lexuesit të ve në dukje një fakt tejet mjerran. Në Hungari lëvizja kundradiktoriale dhe kundrakomuniste zgjati veç dy vite derisa u shtyp me dhunë, zjarr'edhe gjak nga tanket hrushovjane. Megjithatë quhet, (me të drejtë), Revolucioni Hungarez i 1956-ës dhe emrat e të rënëve janë të shkruar me gërma kubitale si martirë të atdheut. Kurse tek ne, atë lëvizje kundrakomuniste e cila me çeta maleve zgjati për dhjetë vite, le që as i ka shkruar kujt në mëndje t'a emërtojë revolucion por as kryengritje jo. Sa u takon pastaj emrave të atyre martirëve duke filluar nga organizatori kryesor si edhe udhëheqësi i asaj rezistence Mark Gjomarkaj e vazhdo me gjithë të tjerët, historia si edhe historianët shqiptarë jo që nuk i zenë në gojë si heronj të lëvizjes kundërkomuniste por përkundrazi, i kanë njolllosur me balt'e tradhëtira të rreme! Që nga pohimi i zotit Loro Kovaçi u desh të kalonin që atëhere jo pak, por pikërisht pesëdhjet'e pesë vite, derisa të më binte në dorë libri me titullin “Një jetë e shkrirë për Fé e Atdhë”, kushtuar MonsinJOR Dr. Zef Oroshit, nga miku si edhe kumbarë i monsinJORIT, autori Tomë MriJaj. Me kureshtje të madhe si edhe gjithë gëzim fillova t'a lexoja vëllimin. Ashtu si në pamjet që të paraqiten parasysh tek kundron brëndësín'e një kaleidoskopi, ashtu filluan të më duken, skenë mbas skene, rravijëzimet që paraqiste libri i tij. Që në faqet e para kuptohej se vëllimi ishte shkruar nga dora e një personi i cili MonsinJORIN jo vetëm që e kish njohur mirë por edhe kishte qen' i afërt me të aq sa vetë MonsinJORI f'ij' e për pé, i kishte treguar rreth ngjarjesh, ndjenjash edhe rrethanash të ndryshme të jetës Tij. Doemos në vazhdim, dora dorës, autori sjell pastaj kujtime personale dhe i shtjellon ato për vite me radhë derisa vjen edhe çasti kur vetë autori përjeton pranë krevatit, kalimin n'Amëshim të MonsinJOR Oroshit! Zoti Tomë MriJaj është nga ana tjetër edhe mik i afërt i Kapidan Ndue Gjomarkut. Ky i fundit, jo vetëm që është një personalitet i madh në vetvete, jo vetëm që ka luajtur rol të vyer si edhe aktiv si pjesëmarrës forumesh drejtuese të

organizmave shqiptare në Perëndim përgjatë dhjetravjeçarëve që pasuan vendosjen e diktaturës komuniste në Shqipëri, por ka qenë shok'edhe mik i MonsinJOR Oroshit që në rinín'e Tij të herëshme ! Kësisoji kuptohet qartë se fati e desh që, autori i vëllimit lidhur me Imzot Zef Oroshin, të kish në dispozicion burime sa të larmishme e po aq krejtësisht të posaçme të cilat nuk ka arkiv që t'ua verë në dispozicion hulumtuesve të zakonshëm. Kush fillon t'a lexojë vëllimin në fjalë, që në fillim befasonet me një moment të cilin dua t'a nënvizoj. Autori i vëllimit citon ... “Burrë është ai që fal dhe mbi fatkeqësinë shtrin dorën e pajtimit, vendos besën e paqës, mirëkuptimit, respektit ndaj njeriut”. Ky pohim është një konsideratë rreth trajtimit që i bën Kanuni i Maleve konceptit “besa e dhânun”, shprehur nga pinjolli i familjes së nderuar të Çokajve, MonsinJORI i ardhshëm Dr.Zef Oroshi. Mirëpo me këtë koncept është i lidhur ngusht'edhe Ndrec Çoku, pararendësi i nderuar i MonsinJORIT. Që në hapat e para të jetës së tij, Dom Zef Oroshi u mëkua me tharmin e etikës dhe moralit të Kanunit dhe në rastin konkret me paragrafin e tretë të nyjes njëqindnjëzet'e dytë (§ 856 i Kanunit) i cili thotë: – Shpija e t'vramit, po i dha besë dorërasit, ky edhe pse e vrau, ka me shkue në mort e në gjâmë m'e përcjellë t'vrámin deri n'vorrim e me ndëjë për drekë. Kjo besë njatë 24 sahat. - Ja pra me pak fjalë ngjarja të cilën na e sjell autori, zoti Tomë MriJaj.

Të parit të Çokajve i a kishin vrarë njerin nga djemtë

I gjithë fisi e ndiqte dorërasin. Ky, duke mos i parë dërmant vetes e duke e ditur se ç'burrë ishte Ndrec Çoku, (i ati i të vrrarit), vete para kullës tij duke thirrur se i kërkonte besë. Dhe malësori kreshnik mirditas i a dha besën e burrit 24 orëshe ! Të nesërmen, mbasi u a kishte marrë besën 30 ditore burrave të familjes Çoku, e përcolli vrasësin e të birit sipas zakonit. U ndala rreth kësaj ngjarjeje të jashtëzakontë, pikërisht për t'a theksuar momentin se si Dom Oroshi i ardhshëm, i cili si meshtár do t'a kish detyrë parësore të tijën “faljen e mëkateve”, ish i pregatitur që nga fëmijëria e tij për këtë rol njerëzor kulmor që i u realizua me mbarimin e Seminarit Pontifikal të Shkodrës e pastaj duke u diplomuar në Universitetin e Urbinos në “Propaganda Fide” në Itali ! Në vazhdim autori i vëllimit, tek i a paraqit lexuesit rezistencën e armatosur të Mirditës si edhe të zonave të veriut mbas vendosjes së diktaturës komuniste, si gurë themeli merr pohimin e Dom Zef Oroshit “...

Mirdita prandej është masakrue dhe masakrohet gjithnjë, posaçë të gjith krahinave të Shqipërisë, sepse rezistencën që ka gjetë dhe gjen aty qeverija e Enverit, nuk e ka gjetë aq të ashpër në asnjë krahinë tjetër ...”. Miqësia e zotit Tomë Mrija me Kapidan Ndue Gjemarkun, i a ka krijuar mundësinë autorit të na sjellë në librin e tij letrën e datës 3 shkurt 1953 me informacion autentik që Dom Zefi i dërgon nga Mitrovica, (ku u arratis sepse në prag arrestimi nga ana e kriminelit toger Baba), mikut të tij të rinisë Kapidanit, mbi gjëndjen në Shqipëri. Ai dokument nuk është një letër dërguar një mikut, dhe aq, por është një analizë gjëndjes vajtueshme në të cilën ndodhej Shqipëria asokohe. Pa i a hequr kërshërinë lexuesit

edhe mua, tisi i harresës u a ka mbuluar atë. Prandaj këto të vërteta duhen kujtuar e rikujtuar papushim se ndryshe harrohen. Shkruan Dom Zefi ndër të tjera “... Për t’ia mbërrijtë kulmit të sovjetizimit, obskurantistët e Tiranës në gushtin e 1952 dekretuen një ligj që ndalon të gjithë librat që janë shtypë para vjetit 1944, si në gjuhë shqipe edhe në gjuhë të hueja; marrja (çmenduria - M.K.) e shekullit të XX-të që i u imponue popullit shqiptar e sidomos asaj pjese të vogël intelektualësh, që ka mbetë gjallë akoma, nga Moska imperialisteshoviniste ! Kjo masë e qeverisë komuniste të cilën na e kujton zoti Tomë Mrija nëpërmjet gojës Dom Zef Oroshtit, duhet lexuar me vëmendje nga brezat e rinj. Po nuk i dijtën dhe t’i



t’a lexojë në kopje të origjinalit dokumentin, (tek libri i z. Tomë Mrija – M.K.), nuk mundem mos të ndalem në një dy pika kulmore që Dom Zefi i a ve në dukje Kapidanit. Në njerin nga kalimet ai pohon “... Me shumë keqardhje, na duhet të thomi, që kurrndonji herë nuk i është shtfë popullit shqiptar sistematikisht një përçamje aq e madhe, me parimin “divide et impera” (përçë e sundo – M.K.), sa ndër kohat e sodit nga klika sunduese e Shqipërisë; përçamje në familje, përçamje në fshatarrsi, përçamje ndër qytetarë, shkaktue nga agjentat e “Sigurimit”, tue privilegjuet të kqijt ose agjentat e tue e shtypë popullin me anën e tyne ...”. Në vazhdim Dom Zefi i a vé theksin nënshtrimit të verbër të udhëheqjes shqiptare ndaj B. Sovjetik si edhe Stalinit dhe ndonjëse brezat e moshuar e kanë përjetuar situatën që Dom Zefi i a përshkruan Kapidan Ndues, atyre jam i sigurtë se si

mbajnë mirë parasysh këta trille të diktaturës komuniste në drejtim të zvogëlimit me dhunë të horizontit kulturor të popullit, mund të vijë një ditë që trille edhe më të dhunshëm mund të zbatohen nga udhëheqës paranojakë! Dom Zef Oroshti ishte një intelektual i mirëfilltë dhe i formuar me kulturë të gjerë shumëplanëshe. Me 16 qershor 1962, në bashkëpunim me Patër Andrea Nargajn, formojnë Shoqatën Katholike Shqiptaro – Amerikane dhe më 1965 ai njihet si Meshtar i Dioqezës së New York-ut. Të dy meshtarët, që në vitin e largët tashmë 1966, themeluan dhe e botuan revistën Jeta Katholike Shqiptare të cilën e drejtoi Dom Zef Oroshti për 12 vite radhazi. Revista tematikën e saj e kishte në masën madhore natyre kishtarë e gjithashtu kulturore. Mbas ndërprerjes ajo rifillon të botohet së rishmi në vitin 1995 nën drejtimin e Dom Pjetër

Popajt dhe vazhdon e botohet rregullisht. Nuk ka se si të mos e mbushë me mallëngjim lexuesin shqiptar fakti se Dom Oroshi nga viti 1960 që u vendos në New York e deri në vitin 1969 meshat i ka ngritur në kisha amerikane derisa i mbështetur fuqimisht nga shqiptarët e diasporës ngriti kishën e parë shqiptare në Park Avenue të Bronx-it. E kësajsoji dora dorës, duke i lexuar faqet e vëllimit të shkruar nga miku i Dom Oroshit, Tomë Mrijaj, shtjellohet para syve të lexuesit jeta e këtij klerikut të shquar, intelektualit të mirëfilltë si edhe atdhetarit të skajshëm.

Zef Oroshi pritej në Vatikan në audiencë të posaçme nga Shënjtëria e Tij Papa Pali i VI-të.

Viti 1970 shënon një pikë kulmore për Dom Zef Oroshin. Ai pritët në Vatikan në audiencë të posaçme nga Shënjtëria e Tij Papa Pali i VI-të. Gjatë shkëmbimit të mendimeve të ndërsjella, Dom Zefi i dhuron Atit të Shënjtë botimin e shqipëruar prej tij të librit “Katër Ungjiat dhe punët e Apostujve.” Me këtë rast Ati i Shënjtë, duke e vlerësuar lart punën e madhe të tij në fushën e kulturës fetare, e nderoi Dom Zef Oroshin me titullin e lartë Monsinjur [Imzot – M.K.]. Çaste kulmore që duhen ndriçuar - Duke i dhënë një goditje të lehtë kaleidoskopit që na paraqit autori rreth jetës dhe veprës Dom Zef Oroshit, riorganizohen kristalet e ngjyrosura dhe si nga fundi i oqeanit del në sipërfaqe një moment madhështor të cilin kleriku i ka pasë shpjeguar me të gjitha nuancat autorit të librit : bashkëpunimi ndërmjet Peshkopit Noli, Dom Zef Oroshit si edhe takimet e tyre me Arqipeshkvin e Bostonit, Eminencën e Tij Kardinal Cushing. Thelbi i bashkëbisedimeve kishte qenë afrimi i Kishës Katolike Shqiptare me atë Orthodoxen, shëmbull ky i një ndjenje ekumenike madhore! Në këtë vazhdë një shprehje e posaçme e konkretizimit të kësaj nisme është edhe përshkrimi tejet i gjallë që i bëhet gjatë librit nga autori i tij, kremtimit madhështor që i u bë përvjetorit të 60-të të themelimit të Gazetës Dielli, ku moment tejet prekës është bashkëcelebrimi i meshës së Shënjtë nga Arqipeshkvi i New York-ut Terence Cardinal Cooke, tre dhespotët arbëreshë të ardhur nga Kalabria si edhe Dom Zef Oroshit! Një nismë kjo ekumenizmi të mirëfilltë ku shiheshin të gërshetuara veprimet e ndërsjella të barinjëve shpirtërorë katolikë në vëllazërim të plotë me udhëheqësit shpirtërorë të ritit të krishterë bizantin. Moment tjetër tejet kuptimplotë rreth pozicionimeve të Monsinjur Oroshit, i cili nuk ka se si të gjëndet në asnjë arkivë por na sillet si dëshmi e gjallë dhe shumë e bukur nga i pranishmi në bisedë, zoti Tomë Mrijaj, është fragmenti i diskutimeve mes Monsinjurit dhe profesor Zef Nekës. Ky i fundit, duke i u referuar tregimit të Monsinjurit me titullin “Çohaja”, [Bariu –

M.K.], i mallëngjyer nga përshkrimet e lexuara në tregim shprehet me lot në sy “... un kam kja si fëmi për atë vend qi po e dishrojmë së gjalli. Ndoshta ai regjim i djallit nuk ka me na e dhanë mundësinë të kthehena e të çmallena me truëllin t'onë, se çdo dit'e po plakena.” Monsinjori mbasi e dëgjoi i u përgjigj “... Fajin e kena vetë e m'at s'shumti na klerikët qi qindruem pasivë e nuk e organizueme popullin të çohëj në këmbë i madh e i vogël, në Veri e Jugë të Shqipnisë, si ortek i madh bore e t'a luftote at murtajë qi na zhgatroi n'temël!” Sa prekës gjatë leximit të librit, përshkrimi që i bëhet çastit kur me nismën e Monsinjur Oroshit, ky i fundit si edhe zoti Tomë Mrijaj vajtën, qëndruan në heshtje në shënjë respekti, si edhe u lutën para varrit të patriotit të shquar Abas Kupit. Dhe çasti kulmor është ai kur Monsinjori pohoi se si kishte thënë meshë për dy vite me radhë për shpirtin e të ndjerit gjeneral Abas Kupit, i cili vetë i kishte lënë amanet [por për një vit – shënim M.K.]. Moment vërtet madhor ky, ku mësohet se si një prelat i krishterë ngre meshë për një bektashî ! Si mos të preket lexuesi tek e përshkruan autori me thjeshtësi por edhe me mjeshtëri pohimin që kish bërë Monsinjori në një rast kur, i shoqëruar nga zoti Tomë Mrijaj, kishin shkuar tek varri i Mithat Frashërit dhe atje takuan krejtë rastësisht para varrit profesor Luan Gashin. Mbas përshëndetjeve Monsinjori ishte shprehur “... Na jena krenarë sot para varrit të Apostullit të Shqypetarizmës ... gjithmon'e kam kujtue e kam m'e kujtue në lutjet e mija derisa të kemë frymë!” Këto ishin disa nga çastet kulmore që desha t'ua vija në dukje lexuesve me shpresën se do t'u nxitet kërshtëria t'a lexojnë të plotë vëllimin në përkujtim të kësaj figure të madhe që ka nxjerrë kombi ynë ! Pak konsiderata shtesë - Vëllimin, materialet e të cilit fluturimthi u mundova sadopak t'i prek, jo rastësisht e krahasova me një kaleidoskop. Dy fjalë tashti të shpjegoj cila qe shtysa t'a bëja një krahasim kësajsoji. Personalisht kam lexuar shumë libra përshkruesë figurash të shquara. Padyshim që në mes lexuesve të këtyre radhëve do të ketë persona që kanë lexuar edhe më shumë se unë libra të kësaj gjinije. Por mendoj se e përbashkëta e jonë, dora dorës që përparonim në leximin e faqeve që autori i ka kushtuar Monsinjur Zef Oroshit, qëndron në faktin se ky libër ka një veçori krejtësisht të posaçme i krahasuar me librat e tjerë: leitmotivi padyshim që është figura e Monsinjurit. Mirëpo gjatë kthimit të faqeve të librit lexuesi ndeshet fillimisht si pa e vënë re e pastaj dora dorës e sheh se ka të bëjë me një libër ku krahas figurës qëndrore, së cilës edhe i përkushtohet ky vëllim, mësohen ngjarje, botime si edhe njihet me hollësira rreth personalitetesh, të cilat të qëmtoheshin veç e veç do të kërkonin kohë të madhe të gjurmoheshin !

Në personin e Monsinjur Oroshit shkriheshin në një Feja si edhe Atdheu

Kështu, teksa autori zë në gojë se në personin e Monsinjur Oroshit shkriheshin në një Feja si edhe Atdheu, mësimet këto që i a kishin mëkuar udhëheqësit shpirtërorë si edhe profesorët e tij Patër Gjergj Fishta si edhe Dom Ndrë Mjeda, mësohet njëkohësisht se në Shkodrën e vitit 1891 funksiononte shtypshkronja me emrin “Shtypshkroja e Zojës së Papërllyeme”, [pronë e Kolegjit Saverian të Shkodrës – M.K.], e cila i filloi botimet me të përkohëshmen “Elçija e Zëmërës së Krishtit”! E pastaj jepet një informacion rreth shtypshkronjave të ngritura në vazhdim si edhe emrat si edhe periudhat e botimeve të dhjetra e dhjetra gazetave, revistave si edhe të përkohëshmeve të ndryshme! P.sh. mësohet se që më 1904 në Romë ka filluar botimi i revistës fetaro-patriotike “Lajmëtari i Shqipërisë” (L'Araldo d'Albania), ose në Napoli (1904 – 1906) botimi i revistës “Shqyptari”, e nuk mund t'a lemë pa e zënë në gojë faktin se mësohet që në Shkodër, në atë qytet të lashtë si dhe vatër kulturore të herëshme fetare dhe kombëtare, qendër ku më hollësisht se askund tjetër në qytetet e trevave shqiptare njihej e analizohej me drejtpeshim Kanuni i Maleve, që më 1920-ën është botuar revista “Grueja Shqyptare”. Përse më la shumë mbresa tek e mësova këtë fakt? Sepse mund të duket e pabesueshme por gratë italiane e kanë fituar të drejtën e votës në vitin 1925! Por ka edhe më keq akoma: grave zvicerane kjo e drejtë i u dha hiç më parë por në vitin 1972! Prandaj informacionet anësore që jepen në vëllimin e zotit Tomë Mrijaj, krahas vetë temës qëndrore rreth personalitetit të Monsinjur Oroshit, janë aq të larmishme dhe të vyera sa që mua personalisht ky vëllim mu duk me vënd të krahasohet me një kaleidoskop për vetë larminë shtjellimeve që sjell para lexuesit! Nga ana tjetër, paralelisht trajtimit të figurës qëndrore të librit, informacion hera herës edhe i gjerë, jepet për personalitete të shquara që historiografia komuniste jo që i ka përbaltur por edhe mohuar si p.sh. Atë Danjel Gjeçaj O.F.M., Tajar Zavalani, profesor Ernest Koliqi, Dom Ndrë Zadeja, Atë Andrea Nargaj O.F.M., profesor, dr. Rexhep Krasniqi, etj.etj.

E për t'a mbyllur me një informacion anësor por tejet interesant dhe të vyer, është përshkrimi që profesor Karl Gurakuqi i bën legjendës se si me vrasjen e Heroit tonë Kombëtar Skënderbeut si edhe dyndjes së ushtrive otomane në trevat shqiptare, figura e Zojës së Këshillit të Mirë nga Kisha e Zojës rrëzë Kështjellës Rozafatit u ngjit në ré, kaloi mbrekullisht detin Adriatik dhe zuri vënd në Kishën e Genazzano-s në Itali ku gjëndet edhe një pllakatë përkujtimore e vendosur në vitin 1932 që përkujton

pelegrinazhin e 340 shqiptarëve të kryesuar nga Arqipeshkvi i Shkodrës Monsinjur Lazër Mjeda si edhe gjashtë hierarkët e kishës së tij ku u lutën që Zoja e Këshillit të Mirë të kthehej nga Genazzano-ja në Kishën e Zojës në Kalan'e Shkodrës. Pllakata është nënëshkruar nga Imzot Luigj Bumçi. Në përmbyllje, dëshiroj t'i kujtoj lexuesit të këtyre radhëve se të shumtë janë njerëzit që kanë njohur njerëz të shquar e doemos kanë ruajtur edhe kujtime prej tyre. Një pjesë e atyre kujtimeve u është thënë të tjerëve ndërsa pjesa më e madhe ... janë harruar së bashku me bartësit e tyre. Kësisoj shumë të pakët janë ata që kujtimet e tyre i kanë hedhur në letër. Sado të varfra që të kenë qenë për nga stili i të shkruarit ato fletë të shkruara, ato janë si vera e ruajtur me kujdes e cila, sa më shumë kalon koha, aq më vyer bëhet. Doemos pastaj kur gërshetohet stili i përshkrimit me madhështinë edhe të personalitetit që përshkruhet, ato u përcillen pastaj brezave pasardhës si kryevepra. Prandaj desha t'i mbyll këto radhë duke shprehur mbresat që më la vëllimi i shkruar nga zoti Tomë Mrijaj duke e cilësuar jetën e Monsinjur Zef Oroshit si një “Jetë e shkrire për Fé e Atdhë”! Autori nuk e kujton Monsinjinorin vetëm si kumbarën e katër fëmijëve të tij. Jo. Ai nuk hedh në letër një profil të një djaloshi i cili i mëkuar me mësimet e fësë e të atdhedashurisë por edhe me etikën dhe moralin e mirëfilltë që përçonte me zbatimin e tij në popull Kanuni i Maleve (kur nuk kishte shtet ligjor), studjon, bëhet famullitar dhe i shërben me përvuajtje popullit të krahinës së tij. Jo, as vetëm me përshkrimin e kësaj ane të Monsinjinorit të ardhshëm nuk kufizohet autori. Nga leximi i vëllimit, dora dorës para lexuesit paraqitet një meshtar me karakter të fortë, një malësor mirditor me tipare si të gdhendura në granit i cili di, kur togër Baba i tmerrshëm i vinte qark t'a arrestonte, edhe t'i marrë leje vëllait të madh që të arratisesh nga Shqipëria, por nga ana tjetër edhe shkrihet në lotë dhimbjeje tek mëson vuajtjet e familjarëve të tij nëpër kampet e internimit të diktaturës. Mirëpo edhe me kaq nuk merr fund përshkrimi i këtij kleriku shumëplanesh. Ky personazh i shquar përshkruhet edhe se ç'vepra madhore të shkruara la mbas vetes së tij si në fushën e predikimit katekizmit të përshkruar nga fryma ekumenike por gjithashtu edhe si njeri me nisma edhe largpamje praktike n'udhëheqje ku kishën e themeluar prej tij veç shërbimit themelor që ajo kishte e konceptoi edhe si çerdhe patriotike! Prandaj nuk më mbetet gjë tjetër t'i them autorit të vëllimit, zotit Tomë Mrijaj, veçse: Ju falënderoj nga zemra për këtë dritë që hodhët mbi jetën dhe veprën madhore të Monsinjur Zef Oroshit e gjithashtu për kaleidoskopin e veçantë letrar që na paraqitët nga i cili gjithsecili ka se çfarë të mësojë!

Fatmira NIKOLLI

KISHA E BALLDRENIT E SHEK.XIII OSE KUR NJË PRIFT MUND NJË SHTET

Unë e kam njohur Dom Nikë Ukgjinin kur ai rrekej të rijetëzonte Kuklin e Ndre Mjedës, kishën dhe muzeun e poetit. Pasi u mbledhën fonde për të një luftë e madhe duhej vetëm për një tabelë në rrugën nacionale ku shenjohej që në ato anë kish jetuar dikur Ndre Mjeda. Në Shqipëri duhet të lëvizësh malet që të dalë dielli, përndryshe në një vend normal dielli ka lindje e perëndim. Ne nuk jemi vend normal.

punës së mirë restaurimi i kishte bojatis varret Kolë Idromenos e Marubit.

Tani ka një vit që Dom Nika merret me kishën e Balldrenit. Objekt i shek XII-XIII, monument kulture me murale të mahnitshme e ku thuhet se “Darka e fundit” e mureve të Shën Premtes së Balldrenit është më e vjetër se e Da Vinçit. Kisha po shkërmoqej, shiu që binte jashtë i lante muralet. Për këtë kishë, i njëjti prift, vetëm mua më ka marrë



E mbaj mend që atëherë pa pikën e drojës merrte në telefon orë e pa orë, kërkonte numra telefoni, pyeste, informonte. Dhe mirë ia bënte. Ai e dinte që ne nuk e lëmë diellin të dalë. I vëmë mal përpara.

Mandej u mor vesh skandali i varrezave të Rrmajit. Po vidhnin tokë varresh për ta shitur për varre. Duhej lëviz prapë mali dhe shteti për këtë nuk lëviz gishtin. Shteti merret me shkresa. Nga një zyrë në tjetrën, mandej diku rruga e shkresave humb dhe mali e zë diellin. U deshën edhe për Rrmajin njerëz që shtynin malin që të ndalohej 'sakrilegji' i shitjes së varreve bashkë me eshtrat. Mandej erdh një kohë që meshtarë me besim se mali lëviz u morën t'i vinin në mbrotje. E mori në dorë qeveria e dihet si shkoi: u restauruan, u bë ceremoni madhështore dhe në fund u mësua se mes

dhjetra herë që të më shpjegojë si është, për se ka nevojë, ose për të më pyetur për njerëz e numra telefoni. Ai nuk ka lënë gur pa lëvizur (jo vetëm ai ka edhe meshtarë të tjerë që rrinë në hije duke i bërë punët pa rënë në sy). Mali filloi të tundej. E panë kishën (çudi si ishte fshehur deri tani) dhe më pas shteti tha: s'kam para. Pra shteti që do të ndërtojë rrugë me 330 milionë euro, shteti ku kompani naftë shkaktajnë dëme që shkojnë 700 milionë euro, shteti që u jep jahteve të multimilionerëve naftë me 0.76\$ litrin pa taksa, akciza e tatime, shteti që paguan gjoba të gjykatës së Strasburgut më shumë se 100 milionë euro, nuk ka para për stadium, as për teatër, nuk ka as për kishën monument kulture. Ashtu si shteti as Dom Nika nuk kishte para.

As ipeshkvia e Lezhës jo e jo. Por ja që Dom Nika dhe ipeshkvia i gjetën me donatorë e



besimtarë për kishën e Balldrenit, shteti jo. Ja pra një prift që mund një shtet. Le të kuptohemi. Ai prift nuk është hero as shpëtimtar. Ai e çmon këtë kishë dhe bën më të mirën sipas tij, ashtu siç di ai. Ai nuk është as specialist trashëgimie, as arkitekt, as restaurator. Ai nuk po kërkon vota. Nuk del as të mbjellë pemë. Hierarkia e kishës është e tillë që ai nuk e bën këtë as për karrierë, as për medalje, as për t'u dekoruar. Të kuptohemi prapë, ruajtja e kishave me rëndësi historike për Shqipërinë nuk është punë priftash. Përkundrazi. “Puna” e priftit mbaron te mesha dhe famullia e tij. Thënë kjo, ai famulli ka Kuklin e Mjedës jo Balldrenin. Pra Dom Nika nuk është hero, e ruajtja e kishave s'është punë priftash, por ndërsa shteti fle, herë nga pafuqia, herë nga mungesa e vullnetit, herë se s'ka 'krahë pune', herë se ska makinë, herë se s'ka naftë, kisha po shembej e dikush duhet ta lëvizë malin. Dhe Dom Nika këtë di të bëjë, të këmbëngulë. Në mënyrën e vet. Në fund të fundit ai bën një punë pa e pasur detyrë, në një vend që detyrën e vet pakkush e bën. (Dhe bashkë me ipeshkvinë e Lezhës kanë nisur mbledhjen e fondeve me donatorë për kishën e Pllanës, po kaq magjepsëse sa e Balldrenit, një ndër shkollat e para shqipe e në po kaq nevojë të dhimbshme për të ndërhyrë te muralet e saj).

Shteti është i mirëpritur në përrurim. Me gjasë do ketë ceremoni madhështore. Kur dielli të ketë dalë, prej atyre që nuk lëvizën gishtin për të lëvizur malin video e foto do qarkullojnë për të na uruar mirëmëngjes. Dom Nika do i kthehet 'anonimatit' të vet dhe shpëtimi i kishës (nëse restaurimi bëhet

mirë) do jetë një nga punët e qeverisë. Kjo e fundit, edhe po nuk u bë mirë restaurimi prapë do ta shesë si sukses. Dhe prapë në kushtet tona shteti duhet falenderuar që hartoi projektin e zgjodhi zbatuesin. Shteti që deri tani flinte më së paku duhet ta supervizojë që duke dashur ta shpëtojnë të mos e zhbëjnë. Mos i ktheni punët në varre (si të Rrmajit).

Marrë nga: *Gazeta Shqiptare*, 26.08.2019



VENDOSET PLLAKATË NË SHTËPINË E MIGJENI! TASHMË TË GJITHË DO KUJTOJMË SE KU LINDI POETI MJERIMIT



108 vjet më parë, më 13 tetor 1911, u lindi Migjeni, në mëhallën Gjuhadol të Fretënve në Shkodër. Me 12 tetor, 2019, nga organizatorët Dom Nikë Ukgjini, Dom Kristian Marku dhe afaristi Gjergj Leqejza, në praninë e studiuesve u rivendos pllaka memoriale në shtëpinë ku banoi poeti e cila sot është pronë e murgeshave Françeskane të Krishit Fëmijë. Në shtëpinë e Migjenit, është rivendosur një pllakat nga artëdashës të poetit, duke i dhënë tashmë një gjurmë të shtuar kësaj figure kaq të rëndësishme të letërsisë shqiptare. Migjeni konsiderohet si një ndër shkrimtarët më të lexuar e më të rëndësishëm të letërsisë shqipe të shekullit të 20-të. Pllaka e hequr gjatë restaurimit në vitin 1996, tashmë qëndron si një memorial e cila dëshmon se Migjeni ka jetuar dhe ka vdekur në atë godinë, duke i dhënë tashmë një gjurmë të shtuar kësaj figure, e cila i dha aq shumë letërsisë.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin mjaft artdashës të poetit të njohur. Konsulli i nderit të Austrisë, Gjergj

Leqejza u shpreh se iniciativa të tilla simbolike duhet të ndërmerren më shpesh.

Studiuesi Zija Vukaj: Ky ishte një event shumë i rëndësishëm për disa arsye, kjo rivendosje e kësaj pllake përkujtimore e cila është si një lloj korrigjimi që ne i bëjmë të kaluarës tone, ku siç duket ne jemi një qytet që bëjmë gafa, por edhe i korrigjojmë ato. Gafat janë emocionale, të pamotivuara nga arsyeja njerëzore, por shpeshherë turmat udhëheqin dhe marrin disa vendime që i vuajnë të tjerët pastaj.

Për Migjenin ka patur shumë diskutime, ai ka qenë i keqkuptuar dhe vazhdon fatkeqësisht për një pjesë njerëzish që janë extra letrar dhe extra artistik të jete i keqkuptuar edhe sot e kësaj dite. Migjeni duke qenë një realist drastik, "të gjithë mendonin se e ka me mua", por ai e ka më të gjithë ata që gabojnë. Duke qenë se gabimet kanë qenë të shpeshta dhe të mëdha ai nuk ka bërë gjë tjetër veçse me ane të veprës së tij ka nxjerre në sipërfaqe të vërteten.





Tonin Çobani
MITOLOGJI SHQIPTARE

ALBAS
Tiranë 2017



At Anton Harapi OFM

THANA E THASHA

Botimet Françeskane 2019



Dom Gaspër Gurakuqi

**FISET E VERIUT DHE
DIOQEZA**

PAKTI
Tiranë 2019

KUMBONA E SË DIELLËS

revistë fetaro-kulturore dymujore
e Kryedioqezës Metropolitane Shkodër-Pult

Tirazhi: 1000 kopje

Çmimi: 100 lekë (Evropë: 2 Euro)

Parapagimi vjetor 600 lekë
(Evropë: 12 Euro)

e-mail: n_ukgjini@yahoo.it

Web page: www.kishakatolikeshkoder.com

Adresa: Arqipeshkvia Shkodër,
Sheshi "Gjon Pali II"

Shtypur në Entin Botues "Gjergj Fishta" - Lezhë